



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për nismën ligjvënëse të shtetasve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Andi Përmeti, Elda Hoti, Aurora Mara, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi dhe Alban Zeneli

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Haki Çako - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC)

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Maksimiljan Dhima - Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit pranë DPEC-së

Alma Mehmeti – Përgjegjëse në Sektorin e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Brendshme

Jonarda Qurku - Përgjegjëse në Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave

Alfred Kristuli - Drejtor në Drejtorinë e MZSH-së

Dëshira Pasko – Drejtoreshë Juridike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Aurela Anastasi – Përfaqësuese e Shoqërisë Civile

Agron Tufa – Drejtor i ISKK-së

Skënder Vrioni – Sekretar i Përgjithshëm i AIDSSH-së

Mirela Lame – Përgjegjëse e Sektorit Juridik

Artur Rroshi –Përfaqësues i AIDSSH-së

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja - Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Shumica e kolegëve janë të pranishëm në këtë mbledhje për të vazhduar me rendin e ditës. Pika e parë është shqyrtimi nen për ne i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Edmond Leka. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe sot kemi prezentë në komision: zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, zotin Haki Çako, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, si edhe stafin që e shoqëron. Kemi gjithashtu edhe përfaqësues nga Ministria e Brendshme.

Zoti Leka, do t’ju lutesha që të më ndiqni në shqyrtimin dhe në miratimin nen për nen aty ku e kemi lënë dje.

Zoti Koçi, aty ku është nevojshme që të ndërhyni me propozime apo sugjerime konkrete jo vetëm ju, por edhe kolegët deputetë jeni të lirë të kërkonit fjalën.

Neni 18 “Këshilli i Ministrave”. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19 “Komiteti Ndërmintorror i Emergjencave Civile”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20 “Komiteti i Mbrojtjes Civile dhe zyra përgjegjëse për situatën”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 “Ministri përgjegjës për mbrojtjen civile”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22 “Ministritë dhe institucionet qendrore”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23 “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24 “Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së”.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – “Drejtorët e tjerë me propozim të ministrit, i emëron Kryeministri”. Çfarë do të thotë “Këshilli i Ministrave”? Megjithatë, si të doni ju, nuk është ndonjë problem.

Ulsi Manja - Kush është dakord me variantin e projektligjit?

Zoti Koçi.

(Zoti Koçi flet pa mikrofon)

Po dhe e emëron Kryeministri, ndërsa këtu thuhet: “Drejtori i Përgjithshëm emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit”. Pra, e kanë lënë që të jetë Këshilli i Ministrave. Kush është dakord sipas variantit në projektligj? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25 “Komisioni teknik këshillimor”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26 “Qendrat e mbrojtjes civile në qark”.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Tek ky nen, njerëzit i ka vetë agjencia pranë çdo qarku. Nuk më duket korrekte: “Përbërja, detyrat dhe funksioni vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Kjo të bëhet me vendim të agjencisë përkatëse. Pse duhet të jetë me vendim qeverie? Përbërja, detyrat dhe funksioni përcaktohen nga ju vetë. A i keni në vartësinë tuaj? Ata do të jenë njerëzit tuaj, të qendrës suaj dhe do të jenë në çdo qark. Kjo është absurde.

Ulsi Manja – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi - Në të gjithë organikën e agjencisë, do të përfshihet edhe kjo.

Ulsi Manja - Në strukturën organike që do të kalojë në Këshillin e Ministrave do të përfshihet edhe kjo?

Petro Koçi - Kurse detyrat, le t'i përcaktojë drejtori.

Ulsi Manja – Ka nevojë për riformulim? Jeni dakord me sugjerimin e kolegut Fino?

Petro Koçi - Dakord.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 26 me riformulimin e pikës 2? Pra, të jeni ju që do ta përcaktoni strukturën. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Seksioni II. Neni 27 “Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile”

Po, zoti Leka.

Edmond Leka - Nuk kemi vërejtje.

Ulsi Manja - Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28 “Prefekti i qarkut”.

Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Kemi një propozim. Në germën “a”, e kishte merak edhe zoti Fino. Thuhet: “Kur është e planifikuar, të paktën 4% e buxhetit vjetor të bashkisë”. Të riformulohet: “4% e fondit vjetor të transfertës së kushtëzuar të buxhetit vjetor”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Nëse do të ndryshohet kjo germë, do të rrëzonte një nga aspektet kryesore të këtij ligji që ka lidhje me iniciativën nga poshtë të reagimit për mbrojtjen civile, për reduktimin e risqeve. Duhet të kuptojmë që 4% e totalit të buxhetit vendor përcaktohet vetëm nga fondet e kushtëzuara që jepen nga qeveria. Këto nuk janë fonde që jepen për emergjencat si dëmshpërblime, por janë fonde për projekte që lidhen me mbrojtjen civile, shpeshherë mund të jenë projekte me shërbim të dyfishtë, mund të jenë projekte që janë për mbrojtjen civile, ndërkohë mund të shërbejnë edhe për infrastrukturë tjetër, siç mund të jetë një argjinaturë, e cila mund të shërbejë edhe si infrastrukturë rrugore në pjesën e sipërme të saj. Është fjala për projekte të mirëpërcaktuara dhe të mirëprogramuara nga pushteti vendor dhe nuk kanë lidhje me dëmshpërblimet. Këto nuk janë fonde që do t’u jepen njerëzve në rast se do të ketë emergjenca. Pra, është projekt zhvillimi.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Këtu duhet të bëjmë një diskutim më të thellë. Për mendimin tim, fondi 4%, që duhet ta krijojë bashkia nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, më duket absurd, sepse nuk mund të ndërhysh ti në bërjen e buxhetit të një bashkie. Bashkia ka dy fonde: fondet e pakushtëzuara që ia jep qeveria dhe fondet e veta nga të ardhurat lokale. Fondet e pakushtëzuara që ia jep qeveria, grantin që japim ne në buxhet, bashkia ka të drejtë që ta detajojë vetë. Ti po i thua: “Nga ky grant do të realizosh 4% për këtë çështje”. Kur i thua këtë gjë i ke ndërhyrë në kompetencat e saj. Kur diskutuam në parim, kam bërë pyetjen: pse 4% dhe jo 5%? Si është gjetur 4%-shi?

Pyetja tjetër: unë jam kryetar i bashkisë dhe e respektova ligjin, e planifikova 4%-shin, po nëse në fund të vitit nuk më ndodh gjë, me 4%-shin e buxhetit të kushtëzuar që janë goxha fonde, çfarë behet? Unë e di që digjet. Në fund të vitit buxheti zërohet dhe fillon buxheti i ri. Nga kjo pikëpamje duhet të shikohet pak me kujdes. Këtu kam përshtypjen, është ajo që kërkova edhe në diskutimin në parim, që duhet të trajtohet dhe të diskutohet me shoqatat e bashkive, të cilat duhet të japin edhe ato mendimin e tyre, pasi preket buxheti i tyre. Ti ua prek buxhetin me një ligj të thjeshtë, ndërkohë që ne kemi bërë një ligj “Për pushtetin vendor” që është me tre të pestat. Këshilltarët e komisionit duhet ta rregullojnë këtë nen.

Ulsi Manja - Po, zoti Koçi.

Petro Koçi - 4% është dyshemeja. Pushteti vendor mund të ndërmarrë hapa për të rritur buxhetin në favor të mbrojtjes civile që do të thotë se duhen për politika më të detajuara dhe më të përparura për reduktimin e risqeve nga fatkeqësitë.

Ky nuk është fond që digjet, ky është për projekte zhvillimi që kanë lidhje me mbrojtjen civile. Prandaj e thashë paraprakisht.

Ulsi Manja - Zoti Koçi, unë kam një pyetje, se dua të qartësohem edhe vetë: 4%-shi që u jepet bashkive si fond i kushtëzuar është nga buxheti i shtetit? Kjo pikë prek të ardhurat që mbledhin vetë bashkitë apo jo? Pra, 4%-shi është vetëm fondi që akordon qeveria nga buxheti i shtetit dhe nuk i prek të ardhurat që krijojnë vetë bashkitë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petro Koçi - Është vetëm pjesë nga fondi i kushtëzuar që u jepet bashkive. Siç kushtëzohet për projekt e tjera, një pjesë e këtij fondi do të jetë i kushtëzuar për projekte të mbrojtjes civile.

Ulsi Manja – Ka dikush për të shtuar?

Ismail Shehu - Kam një koment të thjeshtë: këto fonde janë për mbrojtjen civile, që do të thotë se mund të përdoren për trajnim, për investime, për projekte, për dëmshpërblimet dhe për të gjitha. Deri në fund të vitit nëse nuk realizohet projekti, mund të dëmshpërblehen familjet, mund të trajnohen punonjësit, mund të bëhen investime argjinaturash e të tjera. Pra, është një fond i pastër që qeveria ta jep nga fondet e kushtëzuara të detajuara për mbrojtjen civile, që do të thotë se çfarëdo lloj projekti, investimi, trajnimi, shpërblimi që ka të bëjë me mbrojtjen civile, ke tagrin që ta përdorësh lirisht atë fond.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Cibaku.

Nga ministria, ka ndokush gjë për të shtuar?

Zoti Cibaku – Së pari, unë do të thosha se ky draft i paraqitur përsëri këtu, duhet të ishte konsultuar me të gjitha bashkitë, në këshillin konsultativ, sipas ligjit, gjë që e përcakton qartë edhe ligji 139 “Për vetëqeverisjen vendore”. Unë mendoj se do të kemi shumë problematika me bashkitë, në lidhje me një ligj për të cilin bashkitë nuk e dinë se çfarë po diskutohet sot. Kjo sa i takon kësaj pjese. Ligji “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 6, e përcakton qartë edhe pjesën e përqindjes. Nuk e fikson 4 apo 6, por thotë 3 % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Pra, është një fond rezervë dhe fond kontingjence.

Këtë kompetencë ka këshilli bashkiak, dhe këtë kompetencë ka këshilli vendor. Ky ligj nuk transferohet te ligji “Për vetëqeverisjen vendore”. Ne mendojmë se kjo nuk është e zbatueshme, si në kuadrin e vetëqeverisjes vendore, ashtu edhe të autonomisë së bashkive.

Siç e tha edhe zoti Bashkim, ne mendojmë se ky projektligj duhet të shqyrtohet, së paku në lidhje me këtë pjesë, për të ndarë më qartë nivelet e përgjegjësisë. Kjo punë duhet fiksuar, duhet qartësuar në ligj. Pra, mund t’i delegosh bashkisë një funksion, se edhe ligji e lejon delegimin, por ky delegim duhet të jetë me një preventiv. Delegimi duhet të jetë i përcaktuar. Duhet të ta delegojë ty që të bësh një, dy, tre, katër shërbime për mbrojtjen civile në nivel vendor, por ky shërbim do të ketë një kosto të caktuar, kosto të cilën qeveria do t’ia transferojë bashkisë si fond të kushtëzuar,

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Cibaku.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – E thashë edhe gjatë diskutimit në parim: këshilltarët tanë, bashkë me Ministrinë e Mbrojtjes, duhet të na e koordinojnë nenin 40 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, që ka vendosur dikur 3-përqindëshin, me këtë nen i cili e ndryshon dhe e bën 4 %. Pra, duhet bërë koordinimi i dy neneve, që të jetë në harmoni me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, të mos bjerë ndesh me të. Sepse unë, si kryetar bashkie, jua them edhe një herë: do të respektoj ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, do të caktoj 3-përqindëshin, me të gjitha kushtet që përmendi Cibaku, dhe nuk do ta respektoj këtë nenin 28 të 4-përqindëshit, pavarësisht se do të ma japë qeveria. Pse? Sepse e kam te ai neni që është me tre të pestat,

dhe duhet ta detajoj. Pastaj, në lidhje me mënyrën e detajimit, në qoftë se duhet të ndërhyjmë, le të ndërhyjmë këtu. Le ta detajojmë e të themi se na duhet për trajnime, na duhet për investime, na e të tjera. Por, kur ti thua se nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit, unë duhet t'i them bashkisë se 4 % të fondit do ta marrësh për këtë gjë, do të thotë t'ia japësh të kushtëzuar. Për çfarë duhet ta bëj? Jo t'ua lësh në funksion atyre, sepse ua kushtëzon. U thua: deri në 4 %, dysHEMEJA, siç tha edhe zëvendësministri.

Atëherë ti do t'i thuash bashkisë Tiranë se 4 % do t'i përdorësh për: një, dy tre, katër. Në qoftë se ia jep kështu në buxhet, që në fillim të vitit, jemi në rregull. Në qoftë se nuk ia jep kështu, por i thua: krijo 4-përqindëshin, e pastaj gjatë vitit shikoje si mund ta përdorësh, mundet që të mos e përdorësh fare. Mund të mos ketë asnjë nevojë si bashki. Çfarë bëhet atëherë me këtë? Është fond i konsiderueshëm. Është një fond i cili, realisht i ikën bashkisë. E planifikon, nuk e realizon, e në fund të vitit buxheti digjet. Vitin tjetër planifikohet buxheti i ri. Prandaj, unë mendoj se duhet bërë koordinimi i nenit 40 të ligjit "Për vetëqeverisjen vendore", që e ka 3-përqindëshin, siç e kam thënë në diskutim më parë, me nenin 28, që këta e vënë të kushtëzuar 4-përqindëshin. Duhet të bëjmë një koordinim, që të jetë njësoj, që ky nen të mos bjerë ndesh me nenin 40 të ligjit "Për vetëqeverisjen vendore".

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Në fakt, me sa e kuptoj unë, këtu thuhet 4 % e totalit të buxhetit vjetor, nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, për marrjen e masave në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe për mbrojtjen civile. Pra, edhe kur t'i shkojë bashkisë, do t'i shkojë e specifikuar. E thënë ashtu si e kuptoj: unë do t'i jap 4 lekë, por këto lekë do t'i kesh për emergjencat civile, sepse po t'i jap nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, sepse po e them ashtu siç e kuptoj unë. Sepse në praktikën e punës së bashkive ka ndodhur që, kur shyqyr Zotit, s'ka pasur fatkeqësi, ato 4 lekë të dhëna për emergjencat civile, në çastin kur papritur ka ndodhur fatkeqësia, bashkia nuk ka pasur asnjë lek në arkën e saj, sepse ato lekë i ka çuar në drejtim tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose janë djegur, sepse nuk i ka përdorur për qëllime të mbrojtjes civile, për trajtimin e personelit, për rritjen e kapaciteteve teknike të bashkisë. Më duket se kjo ka qenë logjika. Pastaj, sa i takon përshtatjes me nenin 40 të ligjit "Për vetëqeverisjen vendore", që është ligj i cilësuar, me këtë bie dakord, kjo është çështje juridike, patjetër që mund ta shohim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – A mund të bëj një sugjerim?

Ulsi Manja – Po.

Bashkim Fino – Zotërinj deputetë, e dini çfarë do të thotë të ketë fatkeqësi natyrore? Ka dy elementë: elementi i parë, që është ai i ndërhyrjes së menjëhershme në rastin e fatkeqësisë natyrore. Është edhe elementi i dytë, të cilin do ta shikojmë më vonë këtu, te neni 40, që është elementi i dëmshpërblimit. Edhe në lidhje me dëmshpërblimin, i lihet faturë bashkive. Këta e marrin faturën, në qoftë se do të jetë një faturë super e madhe. Pra, le të themi se kur ndodhin fatkeqësi natyrore, për bashkinë ka dy momente: ndërhyrja e menjëhershme, me të ndodhur fatkeqësia, që bëhen ca investime e të tjera. Është edhe dëmshpërblimi.

Tani, çfarë thoni ju? Ju thoni t’i varim pushtetit vendor dy këmbora në qafë. Thoni: 4 % të buxhetit merre dhe mbaje, që të veprosh në rast nevojë për ndërhyrje të menjëhershme, e në qoftë se s’ke mundësi ti, do të ndërhyj edhe unë, po përveç kësaj ke edhe një faturë tjetër të dëmshpërblimit, e cila do të diskutohet më vonë te neni 40.

Prandaj duhet të jemi të qartë. Duhet ta shohim me qetësi e me kujdes, në funksion të ligjit organik “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili është një ligj i cilësuar, është një ligj me tre të pestat. Sepse kështu po ndërhyjni në kompetencat e tyre. në momentin ë ndërhyjni në kompetencat e tyre, unë bëhem avokati i tyre. Nuk pranoj të ndërhyjni në kompetencat e tyre. Bëni shumë gabim që ndërhyjni kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petro Koçi – Edhe një herë: ligji ka një qasje krejt të ndryshme nga ligji “Për emergjencat civile”. Bëhet fjalë për një politikë ndryshe, e cila ka lidhje me identifikimin, monitorimin, vlerësimin dhe parandalimin e fatkeqësive, reduktimin e riskut nga fatkeqësitë. Ky 4-përqindësh nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me dëmshpërblimin, por ka lidhje me politikën e pushtetit vendor, e cila duhet të ndryshojë rrënjësisht. Bëhet fjalë për një reformë të vërtetë në këtë fushë, cila mbase nuk do t’i ketë efektet brenda pak muajsh, por në përgjithësi në ndërgjegjen shtetërore dhe në përgjegjësinë e madhe që duhet të ketë pushteti vendor sa i takon çështjes së mbrojtjes civile dhe reduktimit të riskut nga fatkeqësitë.

Është një ndryshim shumë i madh. Nuk ka lidhje me reagimin pas fatkeqësisë. Jo. Ka lidhje me marrjen e masave paraprake. Prandaj duhet ky 4 – përqindësh. Sepse deri më tani ka ndodhur që as 3-përqindëshi nuk është respektuar nga pushteti vendor. Pra, është një situatë krejt tjetër. Prandaj i detyrojmë edhe ministritë, që 2 deri në 4 % të fondit ta dedikojnë për mbrojtjen civile.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Koçi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Fino. Pastaj zoti Përmeti.

Bashkim Fino – E para, mos deformato fjalët e mia, se ishe në një linjë me mua kur i thashë. Është tjetër gjë ky investim 4 %, dhe është tjetër dëmshpërblimi, i cili do të hyjë te neni 41 i po këtij ligjit tënd. Mbase do të jesh këtu kur të vemi te neni 41. Unë këtë thashë, nuk thashë gjë tjetër. Ndryshojnë, por janë funksione të bashkisë, jo t’i bëjë bashkia. Prandaj po them se bashkia rëndohet.

Po të bëj një pyetje tjetër: e kthen prefekti një herë, se ia jep të drejtën prefektit ta kthejë për kaq gjë. Ja e ktheu mbrapsht këshilli i bashkisë, nuk e pranoi. Çfarë ndodh? Me dhunë do t’ia bësh ti 4-përqindëshin? E di cili është problemi këtu? Problemi është të ketë mirëkuptim që ta bëjë bashkia një gjë të tillë, sepse duhet bërë. Sepse e thotë ligji.

Zoti kryetar, është si puna e dekretit të Presidentit, që e mora vesh se fatkeqësisht më ka kthyer prapë edhe ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Çfarë bëme ne te ai ligji “Për vetëqeverisjen vendore”? Krijua te çdo bashki njësinë për emigracionin, ndërsa ai e kthen mbrapsht. Po mirë bën. Megjithëse unë jam babi i atij ligji, se e kam bërë vetë, do t’i kthej përgjigje në parlament. Tani, kështu është edhe kjo pikë. Ja, e ktheu prefekti. I thotë bashkisë Tiranë: ti s’e ke planifikuar dyshe-menë 4 %. Ja, këshilli e miraton, por i thotë jo, sepse unë këto fonde do t’i harxhoj për tjetër gjë. Çfarë ndodh? Pra, duhet një koordinim, për ta bërë tamam efektiv këtë ligj.

Prandaj e thashë edhe në fillim: pse s’i mbani vetë fondet ju? Se këto janë të kushtëzuara, i keni ju fondet. Mbani fondet, interesohuni. Bashkia le të bëjë punën tjetër, në daçi atë të dëmshpërblimit, në daçi atë të ndërhyrjes.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Përmeti e ka fjalën. Pastaj do ta hedhim në votim.

Po, zoti Përmeti.

Andi Përmeti – Këtë doja të thosha edhe unë, sepse isha në një linjë me zotin Fino. Kjo është çështje diskutimi juridik dhe jo çështje diskutimi politik, siç e trajtoni ju, zoti Koçi. Kjo do të thotë se, kur ne kemi një konflikt në hierarkinë e ligjeve, nuk mund të mbivendosim një ligj mbi ligjin me tre të pestat. Kështu që, duhet parë me kujdes se si duhet përshtatur. Është diskutim i mirëfilltë juridik. Politikisht thua se ka interes. Po juridikisht?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Përmeti!

Ta hedhim në votim nenin 28.

Zoti Cibaku – A mund të shpreh një opinion nga agjencia?

Ulsi Manja – Jo, zoti Cibaku. Madje edhe fakti që nuk është konsultuar me bashkitë nuk është pjesë e kësaj tryeze, sepse ligji bashkëngjitur ka tabelën e konsultimit publik. Ka kaluar edhe në Këshillin e Ministrave, dhe kur të vijë në Kuvend, janë ezauruar të gjitha fazat e konsultimit publik. Komisioni përgjegjës, që është Komisioni i Sigurisë, nëse nga pikëpamja e procedurës parlamentare do ta çmojë se ka nevojë edhe për një konsultë tjetër me aktorë dhe faktorë që aksesojnë në këtë ligj, këtë e organizon vetë ai komision. Ne jemi këtu për të parë bazueshmërinë e këtij ligji në Kushtetutë dhe në kuadrin tjetër ligjor.

Patjetër që ndërhyrjet e zotit Fino dhe të zotit Përmeti në lidhje me pasjen e një konflikti ligjor mes ligjit “Për organet e vetëqeverisjes vendore” dhe të neneve të caktuara të këtij ligji, janë pjesë e detyrës së këtij komisioni.

Tani, neni 28 ka ardhur sipas këtij varianti, të cilin e kemi në tekstin e projektligjit. Nëse ka propozime konkrete, sipas Rregullores jam i detyruar të hedh në votim propozimin që është më larg variantit të qeverisë, e pastaj të hedh në votim nenin 28, sipas këtij varianti.

Unë shoh këtu se ka diskutime dhe rrahje mendimesh, por nuk shoh propozim konkret. Në këto kushte, unë do të hedh në votim nenin 28.

Kush është pro nenit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mund ta merrni fjalën.

Elena Xhina – Zoti kryetar, s’është e nevojshme të bëjmë riformulimin, pasi nuk është aq e thjeshtë. Duhet bërë rakordimi mes dy ligjeve. Mendoj t’ia lëmë si sugjerim komisionit përgjegjës, që të bëjë rakordimin e duhur midis ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit aktual, që po diskutojmë, meqenëse kemi këtë lloj përplasjeje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 28, me sugjerimin nga ne si komision për dhënie mendimi, për komisionin përgjegjës në lidhje nenin 28, germa ‘a’?

Pro” Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është 1 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Bashkim Fino – Jam kundër, sepse ky është komision përgjegjës për ligjet, që të bëjë koordinimin e neneve të dy ligjeve shumë esenciale. Na takon neve ta bëjmë këtë koordinim duhet t’ia shpiem komisionit përgjegjës dhe jo t’ua lëmë atyre, sepse unë besoj se ata nuk janë kompetent për ligjin e pushtetit vendor.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Neni 29, “Komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 30, “Bashkitë”.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Dua t’i bëj një pyetje zëvendësministrit. Këtu thuhet: “Brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bashkitë kryejnë vlerësimin e risqeve në territorin e tyre duke hartuar, miratuar dokumente” e të tjera me radhë. Përse duhet të vihet ky përcaktim kur ne në ligjin “Për pushtetin vendor” e kemi pasur 3% dhe risqet në çdo territor të bashkive janë duke u bërë hap pas hapi për çdo vit? Ne u themi bashkive që brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi, pra hyn në fuqi tani dhe tre vjet më pas çdo bashki duhet të tregojë një hartë për risqet. Bashkitë e kanë një gjë të tillë, por janë të pakoordinuara.

Ulsi Manja – Çfarë problemi ka?

Bashkim Fino – Afati 3-vjeçar duhet hequr, sepse bashkitë e kanë hartën. Pra, nuk ka nevojë t’u thuash bashkive që mbas tre vjetëve pasi hyn në fuqi ligji të bëjnë hartën e rrezikut, sepse ato e kanë.

Ulsi Manja – Nëse nuk e kanë, duhet ta bëjnë brenda 3-vjetëve. Kjo besoj se nuk ka ndonjë problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nëse e heqim shkronjën “n” të nenit 30, a e zgjidh problemin që keni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Koçi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petro Koçi – Nga informacioni që kemi, asnjë bashki nuk e ka bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, mbani qetësi.

Petro Koçi – Ky është një detyrim nëpërmjet ligjit dhe jo urdhrave apo porosive.

Me hyrjen në fuqi të ligjit, çdo njësi e qeverisjes vendore duhet të bëjë hartën e rreziqeve, sepse në zona të ndryshme mund të ketë industri të rrezikshme, gjeografi me probleme, lumenj problematikë e të tjera.

Bashkim Fino – Ju thoni se bashkitë nuk kanë hartë rrezikshmërie, kjo sipas jush, ndërsa unë them se ato kanë. Ju u thoni: “Mbas hyrjes në fuqi të ligjit do të duhen 3 vjet për të bërë hartën, gjithashtu duhen 3 vjet për të planifikuar 4%”, i cili shkon rreth 12 % e këtij fondi dhe nuk do të përdoret, sepse bashkitë nuk kanë hartë ku ta përdorin. A e kuptoni se bini ndesh me atë që thoni?

Ulsi Manja – Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Meqë zëvendësministri thotë që shumë bashki nuk e kanë atë hartë, a mund të marrim një informacion se sa përqind e bashkive e kanë bërë nivelin e riskut?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Haki Çako – Nga analiza që kemi bërë ne, nuk ka asnjë bashki që ka bërë vlerësim risku në territorin e vet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çako!

Kush është pro nenit 30? Kundër? 2 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 31. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te seksioni III “Strukturat operacionale të mbrojtjes civile”, i cili fillon me nenin 32.

Neni 32, “Strukturat operacionale të mbrojtjes civile”.

Zoti Leka, jeni dakord me nenin 32?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33, “Detyrat e strukturave operacionale të mbrojtjes civile”.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34, “Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 35, “Policia e Shtetit”.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 36, “Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe i shpëtimit”.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37, “Shërbimi i urgjencës mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor”.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 38, “Shërbimi i vullnetarëve në mbrojtjen civile”.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu IV “Gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe masat e jashtëzakonshme”, i cili fillon me nenin 39.

Neni 39, “Gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe masat e jashtëzakonshme”.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 40, “Kategorizimi i emergjencave civile”

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Relatori është dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 41, “E drejta e kompensimit”.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Shikoni se çfarë shkruajnë këta në projektligj te neni 41, për kompensimin e bashkive. E para, për dëmet e shkaktuara përgjigjet shteti shqiptar, bashkitë dhe ju si emergjenca.

Te pika 3 thuhet: “Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensim, atëherë duhet t’i planifikojnë për vitin pasardhës deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara”. Pra, faturën ua lënë 100% bashkive, e cila mund të jetë një kompensim shumë i madh.

Pika 4 është më interesante dhe thuhet: “Në rast se vlera e kompensimit e kalon 8% të buxhetit të bashkisë (këtu dua të di se si e keni bërë këtë vlerësim dhe keni arritur me 8%), AKMC-ja mund të vendos ta kryejë kompensimin”. Pra nuk vendos, por edhe mund të vendosë që AKMC-ja të kompensojë.

Zoti kryetar, së pari, bashkive u themi me ligj të krijojë një fond me 4% për të bërë trajnimet, ndërhyrjet e të tjera me radhë brenda vitit, nga ana tjetër u themi se nëse kompensimi e kalon 8% të buxhetit, pra llogariteni 8% është afërsisht gjysma e buxhetit të bashkive që planifikohet për emergjencat dhe për dëmet që shkaktohen. Unë pyes se kush i tregon bashkisë që po i kaloi 8% të buxhetit atëherë mund të ndërhyjë AKMC-ja? Ne mund të themi: bashkia e bën kompensimin, por kur kompensimi kalon një vlerë të caktuar, pra duhet vendosur një vlerë absolute, atëherë duhet të ndërhyjë AKMC-ja për dëmshpërblimin. Kjo sepse bashkitë nuk kanë mundësi të bëjnë edhe trajnime, edhe ndërhyrje, edhe vlerësimin e dëmit, edhe të shpërblejnë qytetarin brenda vitit, por, nëse nuk ka mundësi, fatura i kalon vitit pasardhës, pra i shtohet buxhetit, pastaj, nëse fatura kalon 8% e buxhetit, mund të ndërhyjë AKMC-ja. Kush e ka përcaktuar këtë 8% të buxhetit të bashkisë?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Koçi, na jepni një shpjegim për pikën 4 të nenit 41.

Petro Koçi – Te pika 3 thuhet: “Nëse bashkia nuk e arrin kompensimin me 4%, sepse mund ta ketë harxhuar për projektin, atëherë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, nëse bashkia nuk e përballon emergjencën e atij viti me fondin që ka në dispozicion, që është 4% i buxhetit, i cili mund të jetë harxhuar pjesërisht për projekte, atëherë i është lënë detyrë që kompensimin ta vazhdojë edhe vitin tjetër, prandaj është lënë 8%. Në rast se fondi 2-vjeçar e kalon 8%, atëherë ndërhyhet.

Kështu veprohet edhe sot. Në ligjin aktual të emergjencave civile thuhet: “Në rast se bashkia nuk mundet të përballojë kompensimin, atëherë e kryen AKMC-ja”, pra nuk ka ndryshim nga ligji aktual.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Përmeti.

Andi Përmeti – Kam dy pyetje. E para, në pikën 3 thuhet: “Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë planifikohet për vitin pasardhës”. Në një fatkeqësi natyrore, siç ndodhi në Floq, ku shtëpitë janë shembur dhe njerëzit kanë ngelur rrugëve, a do të rrijnë edhe vitin pasardhës rrugëve?

E dyta, në aspektin ligjor më duket një çmenduri që në pikën 4 të shkruhet: “Mund të vendosë të kompensojë”. Çfarë ndodh nëse nuk vendos të kompensojë?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Çdo gjë ka lidhje me proporcionalitetin e ngjarjes, ashtu siç ndodh edhe sot. Ne sot fillojmë ndërtimin e shtëpisë së parë në Floq, pastaj në Vidohovë dhe në bashkinë tjetër. Pra, kjo bëhet në përputhje me proporcionalitetin e ngjarjes dhe ngarkesës buxhetore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithmonë është në proporcion me ngjarjen dhe përmasën e fatkeqësisë, pra detyrimi buxhetor që duhet për të kompensuar, rindërtuar e kështu me radhë.

Ulsi Manja – Zoti Koçi, nuk e di se kush e ka hartuar ligjin, por te fjalia “AKMC-ja mund të vendosë”, fjala “mund” nuk shkon. Çfarë vlere ka fjalia nëse e lëmë me fjalën “mund”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ligj fjala “mund” është subjektive, pra nëse e vlerëson, atëherë mundet, por nëse nuk e vlerëson ngelet. Unë mendoj të hiqet fjala “mund” në pikën 4 dhe të vendoset përcaktuese në ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Shehu, si është vlerësuar 8%?

Ismail Shehu – Është llogaritur duke pasur parasysh interesin e qytetarëve që janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore apo të tjera. Nëse bashkia nuk arrin të dëmshpërblejë nga fondet që ka planifikuar për emergjencat, që masivisht nuk ndodh, sepse nuk planifikohet asnjë fond nga pushteti vendor dhe të gjithë adresohen te emergjencat civile, me këtë ligj ne u themi që me 4% planifiko edhe mbulimin e dëmtimit nga fatkeqësitë e familjeve. Nëse për një vit bashkia nuk ka fonde, atëherë u jepet edhe një mundësi për vitin tjetër dhe detyrimi shkon në 8%, nëse detyrimi shkon mbi 8% atëherë de facto bashkia nuk ka kapacitete ta përballojë dhe ndërhyt pushteti qendror, pra në mënyrë që interesat e qytetarëve të plotësohen.

Ulsi Manja – Pra, supozojmë që 4% që nuk do të mjaftojë për kompensim në vitin 2019, atëherë planifikohet edhe një 4% për vitin tjetër dhe nëse kalon 8% do të ndërhyt ju? Kjo është logjika?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj. Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, ju mund të ngelni i kënaqur nga përgjigjja, ndërsa unë ngelem i pakënaqur, sepse bie ndesh me ligjin e pushtetit vendor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, më dëgjoni se pastaj votoni me shpejtësi. Kjo pikë bie ndesh me ligjin “Për pushtetin vendor”, nuk mund t’ia vendosë Ministria e Mbrojtjes, apo dhe ne me ligj këtë 8% bashkisë. Ne bëmë debat për 4%-shin që ishin nga fondet e kushtëzuara të qeverisë, pra, qeveria i thotë “do ta plotësosh këtë 7%” dhe jo ta përdorësh si do ti me vendim këshilli. Nga 3 që ishte në ligj e bëmë 4. Tani, t’i thuash që në rast se vlera e kompensimit e kalon 8% të buxhetit të bashkisë, mua më duket jo korrekte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Shehu.

Ismail Shehu – ...shumë e thjeshtë teknike. Nuk është ideja që do të mbajë 8% bashkia dhe po i shtojmë barrë ekstra. Nëse vlera e kompensimit shkon në 8% fatkeqësia ka qenë e përmasave të tilla sa që detyrimi për familjarët është sa 8%-shi i buxhetit të bashkisë, atëherë është evidente që bashkia nuk ka kapacitete ta përballojë dhe ndërhyjmë ne. Pra, nuk është se 4% është plus për bashkinë, bashkia do të mbajë 4%-shin e vet, por nëse dëmet janë të tilla sa arrijnë 8% të vlerës së buxhetit, atëherë e përballojmë ne.

Vlera e kompensimit e tejkalon 8%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, nuk jemi në grup pune, por në diskutimin nen për nen të projektligjit “Për mbrojtjen civile”. Nëse ka propozim konkret, se nuk del e qartë norma, ju lutem silleni! Meqë propozim konkret nuk ka, thuhet që norma nuk është e qartë te pika 4, prandaj ta riformulojmë dhe të nxjerrim të qartë qëllimin që ka ligjvënësi dhe jo të mbërthehemi në diskutime.

Këshilltarët e komisionit, relatori, juristi i Ministrisë së Mbrojtjes, ta zbardhim nenin 41 dhe të dalë i qartë formulimi, në mënyrë që t’ia çojmë raportin komisionit përgjegjës për dhënie mendimi. Logjika e nenit 41 nuk shton barrë mbi bashkitë 4%. Ngelet po ai detyrim që kanë bashkitë. Qartësojeni kur të zbardhim nenin 41!

Kush është dakord me nenin 41 me këtë ndryshim, edhe me heqjen e fjalës “mund”?

1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë të neni 42 “Masa të jashtëzakonshme:

Zoti Leka?

Edmond Leka – Jam dakord.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë të kreu i pestë “Mbrojtja e infrastrukturës kritike dhe e trashëgimisë kulturore”. Ky kre fillon me nenin 43 “Infrastruktura kritike”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 44 “Infrastruktura kritike me efekt ndërkufitar”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 45?

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 6 “Paralajmërimi i hershëm, monitorimi, njoftimi dhe alarmi”.

Ky kre fillon me nenin 46.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 47.

Jeni dakord?

Edmond Leka – Dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 48 “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, të humbjeve nga fatkeqësitë”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 49.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 50.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 51.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 52.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 7 “Bashkëpunimi ndërkombëtar”.

Ky kre fillon me nenin 53.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 54.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 55.

Edmond Leka – Më falni, zoti kryetar, te neni 55 në fund të shtohen fjalët “sipas legjislacionit në fuqi”.

Ulsi Manja – A jeni dakord me shtesën në nenin 55?

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 56.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë të kreu 8 “Të drejtat dhe detyrimet e shtetasve”.

Ky kre fillon me nenin 57.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 58.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 59.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë të kreu 9 “Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve private dhe të organizatave jofitimprurëse”.

Ky kre fillon me nenin 60.

Jeni dakord, zoti Leka?

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 61.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 10. “Arsimimi dhe trajnimi”.

Ky kre fillon me nenin 62.

Jeni dakord, zoti Leka?

Edmond Leka – Dakord

Ulsi Manja - Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 63.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 11 “Financimi”, i cili fillon me nenin 64.

Edmond Leka – Kemi një sugjerim te neni 64. Pika 1 e nenit 64 të riformulohet, pasi buxheti i ministrive është i ndarë nga buxheti i shtetit dhe nuk është e nevojshme të ndahet më vete. Pika 1 të riformulohet kështu: “Buxheti i mbrojtjes civile të institucioneve qendrore përbëhet nga buxheti vjetor i çdo ministrie i parashikuar zë më vete për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile”.

Ulsi Manja – A jeni dakord me riformulimin e germës “b” të bërë nga relatori?

Dakord qenka edhe ministria!

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 65.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 66.

Zoti Leka, a jeni dakord?

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 12 “Inspektimi dhe kundërvajtjet administrative”.

Ky kre fillon me nenin 67.

A jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk shoh te neni 67 germë “f”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Germa “c”?

Dakord.

Te neni 67, pika 2, germa “c” propozohet të hiqet fjalia “planifikimi i fondeve nga institucionet publike dhe strukturat qendrore dhe vendore”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 68.

Edmond Leka – Te neni 68 kemi një propozim. Në këtë nen togfjalëshi “shkelja e njërës prej dispozitave të parashikuara në germat...” të zëvendësohet me fjalët “shkelja e kërkesave të parashikuara në germat...”. Është çështje teknike. Po kështu, në pikën 1

rekomandohet që masa e gjobës të përcaktohet me interval, pasi kemi të bëjmë me disa lloje shkeljesh, që kanë rëndësi të ndryshme. Zoti kryetar, a mund të bëj një propozim?

Ulsi Manja – Po.

Edmond Leka – Kjo gjë të jetë nga 100 deri në 200 mijë lekë .

Ulsi Manja – Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Në mënyrë që ky propozim të qëndrojë për nga përputhshmëria me ligjin, na duhet të verifikojmë në ligjin “Për kundërvajtjet administrative”, sepse aty jepen kriteret kryesore se si vendosen gjobat. Nëse çështja e gjobës progresive është e parashikuar ligjin “Për kundërvajtjet administrative” mund ta vëmë. Kështu që duhet të jemi shumë në përputhje, përndryshe ai ligj do të prevalojë mbi këtë ligj, sepse është ligj specifik. Atje janë rregullat kryesore për vendosjen e gjobave. Le ta verifikojnë këshilltarët nëse është në përputhje, apo jo.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Masa e gjobës vendoset këtu dhe u referohet parimeve dhe procedurës që ndiqet te ligji për kundërvajtjet. Parimisht në dhjetëra ligje gjobat nuk kanë qenë fikse aq më tepër kur nuk i referohet një rasti, por disa. Pra, propozimi i zotit Leka që të jetë nga 100 deri në 200 mijë lekë është i drejtë.

Ulsi Manja – Nuk ka asnjë lloj problemi, mjafton që të mos bjerë ndesh me ligjin “Për kundërvajtjet administrative”. Hajde ta përshkallëzojmë masën e gjobës te pika 1 sipas propozimit të relatorit dhe, në momentin e zbardhjes së ligjit, këshilltarët të shohin përputhshmërinë e kësaj pike të nenit 68 me ligjin “Për kundërvajtjet administrative”. Edhe ministria është dakord të kemi masë të përshkallëzuar të gjobës.

Kush është dakord me nenin 68, me sugjerimin e zotit Leka?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 69.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 70.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 71.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13 “Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare”

Kreu fillon me nenin 72 “Nxjerrja e akteve nënligjore”.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 73.

Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 74.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 75 “Hyrja në fuqi.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ky projektligj të zbardhet nga këshilltarët dhe relatori, të bëhet gati raporti përkatës për Komisionin për Sigurinë Kombëtare sot dhe t’i përcillet komisionit po sot. Ditën e enjte do t’i kalojë seancës plenare.

Zotërinjtë Koçi, Shehu, Qako, Cibaku dhe gjithë ju të ftuarit e tjerë, ju falënderoj dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për nismën ligjvënese të shtetasve në Republikën e Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Andi Përmeti, Elda Hoti, Aurora Mara, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi dhe Alban Zeneli

Të ftuar:

Dëshira Pasko – Drejtoreshë Juridike në Komisionin Qendror të

Zgjedhjeve

Aurela Anastasi - eksperte

Ulsi Manja – Pika e dytë e rendit të ditës është “Shqyrtimi dhe miratimi nen për nen i projektligjit “Për nismën ligjvënëse të shtetasve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relator është kolegu Damian Gjikhuri. Nga KQZ-ja kemi të ftuar zonjën Dëshira Pashko, drejtoreshë Juridike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe profesoreshën Aurela Anastasi, përfaqësuese e shoqërisë civile.

Zoti Gjikhuri, projektligji “Për nismën ligjvënëse të shtetasve në Republikën e Shqipërisë” është diskutuar gjatë në Komisionin e Ligjeve. Kjo nismë është propozim i koleges Vasilika Hysi, të cilën nuk e kemi prezent në mbledhjen e Komisionit të Ligjeve sot për shkak të një axhende tjetër parlamentare.

Ky projektligj është i dërguar edhe Komisionit të Venecias, i cili ka sjellë një opinion.

Grupi i punës, relatori dhe nismëtarët kanë punuar për ta sjellë në variantin që ne kemi sot në tavolinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, janë reflektuar ..

(Mungesë incizimi)

Janë reflektuar sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Venecias.

Relatori, zoti Gjikhuri, zonja Anastasi, zonja Pasko, zonja Hysi dhe këshilltarët e komisionit thonë se drafti që kemi sot është i dakordësuar dhe ne mund të fillojmë pa humbur kohë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të këtij projektligji.

Zoti Gjikhuri, keni diçka për të shtuar?

Damian Gjikhuri – Jo, nuk kam asgjë.

Ju e bëtë shumë mirë përmbledhjen tuaj dhe unë mund të them se drafti tashmë, edhe me komentet dhe rekomandimet, qoftë të Komisionit të Venecias, të cilat janë reflektuar, qoftë puna shumë e mirë që është bërë në bashkëbisedim me të gjitha organizatat e përfshira si propozuese, mendoj se jemi para një drafti, të cilin mund ta kalojmë shumë thjeshtë, me të gjitha ndryshimet e propozuara nen për nen. Mendoj se realizohet plotësisht edhe kërkesa e iniciuesve, por, mbi të gjitha, parimi kushtetues, e drejta e shtetasve me të drejtë vote për të propozuar nisma ligjvënëse.

Unë nuk dua të zgjatem shumë në këtë drejtim dhe mendoj të kalojmë direkt te propozimet që janë bërë dhe janë pasqyruar në tabelën krahasuese, bashkë me komentet përkatëse se cili ka qenë racionaliteti pas këtyre ndryshimeve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjikhuri!

Zonja Anastasi, keni diçka për të shtuar para se të fillojmë shqyrtimin nen për nen apo do të ndërhyjni në momente të caktuara kur të diskutojmë?

Aurela Anastasi – Unë nuk kam asgjë për të shtuar, por dua të them se këtu janë paraqitur edhe ndryshimet e bëra si rezultat i sugjerimeve që kanë dhënë institucionet e pavarura, si: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtës për Informim dhe të Dhënave Personale.

Nëse ka paqartësi, komente apo pyetje, mund të ndërhyjmë nen për nen.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Ky projektligj ka kaluar në parim.

Vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1.

Damian Gjknuri – Për nenin 1, sipas tabelës krahasuese që kemi bërë, ka një ndryshim në propozim, që e keni në tabelën bashkëlidhur. E keni të nevojshme ta lexoj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam dakord ta miratojmë siç është.

Ulsi Manja – Në nenin 1, termi “shtetas” propozohet të zëvendësohet me termin “zgjedhës”.

Kush është dakord me nenin 1 “Qëllimi dhe objekti i ligjit”. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Parimet bazë”.

Damian Gjknuri – Për nenin 2 “Parimet bazë” kemi bërë propozimin përkatës. Nëse teksti është i nevojshëm, mund ta lexoj, por janë marrë parasysh rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizimet”.

Damian Gjknuri – Në nenin 3 “Përkufizimet” janë saktësuar konceptet, sidomos termi “shtetas”, i cili mund të sjellë konfuzion, sepse “shtetas” quhen edhe të sapolindurit, ndërsa në termin “zgjedhës” hyjnë personat me të drejtë vote, ndaj mendoj se është bërë një përcaktim shumë i mirë. Ta miratojmë me propozimet dhe kufizimet që janë bërë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjknuri!

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4.

Damian Gjikhuri – Për nenin 4 “E drejta për nismën ligjvënëse” ka riformulime për t’iu përshtatur gjuhës juridike dhe unë mendoj ta kalojmë me propozimet e bëra nga stafi i komisionit.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5.

Damian Gjikhuri – Në nenin 5 janë reflektuar opinionet e Komisionit të Venecies dhe të organizatave me të cilat jemi konsultuar. Mendoj se hartimi dhe propozimi i nismës ligjvënëse të bëhet sipas propozimit të riformuluar që kemi në tavolinë. Jam dakord të miratohet kështu siç është.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6.

Damian Gjikhuri - Neni 6, sipas riformulimit të bërë, duke reflektuar Komisionin e Venecies, ODIHR-in dhe disa rekomandime të ardhura nga organizatat e përfshira në procesin konsultativ, si relator propozoj të miratohet me draftin e riformuluar, siç është në kolonën e dytë.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 6, sipas sugjerimeve të bëra nga relatori, ku janë reflektuar edhe opinionet e Komisionit të Venecies? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7.

Damian Gjikhuri – Për nenin 7 nuk ka ndryshime dhe do të miratohet siç është.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8.

Damian Gjikhuri – Në nenin 8 “Financimi”, janë marrë parasysh opinionet e Komisionit të Venecies dhe konsultimet që janë bërë me organizatat e përfshira. Mendoj se në formën finale është i mjaftueshëm dhe i pranueshëm, ndaj të miratohet siç është.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9.

Damian Gjijnuri – Në nenin 9 “Caktimi dhe miratimi i mjediseve për mbledhjen e nënshkrimeve”, ku kemi rekomandimin e Komisionit të Venecies, ODIHR-it dhe rekomandimet nga konsultimet, propozoj të riformulohet dhe ta miratojmë siç është në kolonën bashkëlidhur. Pra, neni 9 miratohet me propozimet që kemi bërë ne si komision bashkë me stafin.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 9, sipas propozimit përkatës në kolonën e tretë të tabelës? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10.

Damian Gjijnuri – Në nenin 10 janë bërë disa saktësime dhe rregullime për mbledhjen e nënshkrimeve, nda jpropozoj të kalohet dhe të miratohet sipas variantit të riformuluar.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11.

Damia Gjijnuri – Neni 11 ka të bëjë me procedurat për mbledhjen e nënshkrimeve. Mendoj se varianti përfundimtar, i riformuluar sipas sugjerimeve të ardhura nga organizatat e përfshira në konsultë, është i duhuri.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11, sipas variantit të propozuar dhe të riformuluar nga relatori.

Neni 12.

Damian Gjijnuri - Në nenin 12 “Procedura e veçantë” kemi bërë disa reflektime dhe saktësime, ndaj mendoj se varianti i riformuluar është i dakordësuar dhe shumë i plotë për t’u miratuar.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13.

Damian Gjijnuri – Në nenin 13 “Mbledhja e nënshkrimeve elektronike” kemi reflektuar opinionin e Komisionit të Venecies dhe konsultat e bëra me organizata e përfshira. Mendoj të miratohet varianti i riformuluar në kolonën e dytë.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14.

Damian Gjijnuri – Në nenin 14 “Afati për mbledhjen e nënshkrimeve” janë reflektuar sugjerimet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe konsultat që kemi bërë. Mendoj se drafti i ri i propozuar është shumë gjithëpërfshirës dhe merr parasysh të gjitha procedurat e njohura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndaj propozoj të miratohet siç është.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 15.

Damian Gjijnuri – Në nenin 15 “Verifikimi i nënshkrimeve” janë reflektuar opinionet e Komisionit të Venecias dhe opinionet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndaj mendoj ta miratojmë me variantin e riformuluar.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 16.

Damian Gjijnuri – Në nenin 16 “Depozitimi i nismës ligjvënëse” kemi bërë riformulime dhe saktësime, ndaj mendoj që titulli “Depozitimi i nismës ligjvënëse” të miratohet me variantin e riformuluar.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 16 me variantin e riformuluar? Kundër?
Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17.

Damian Gjijnuri – Në nenin 17 “Ankimi ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” kemi bërë riformulime duke marrë parasysh edhe opinionet e Komisionit të Venecias, ndaj mendoj se drafti është i plotë dhe të miratohet siç është.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 18.

Damian Gjijnuri – Neni 18, edhe sipas Komisionit të Venecias, është propozuar të hiqet.

Ulsi Manja - Kush është dakord të hiqet neni 18 nga teksti i projektligjit? Kundër?
Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Hiqet nga teksti i projektligjit neni 18.

Kur të zbardhet teksti integral, të rinumërtohen nenet nga e para.

Këshilltarët ta kenë në konsideratë këtë kërkesë.

Neni 19.

Damian Gjikhuri – Neni 19, i cili do të rinumërtohet, është pjesë e sanksioneve. Ne kemi bërë disa rregullime dhe mendoj të kalojë me propozimet e fundit që kemi në kolonën e dytë.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 20.

Damian Gjikhuri – Neni 20 “Hyrja në fuqi e ligjit”.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi.

Ulsi Manja - Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për nismën ligjvënëse të shtetasve në Republikën e Shqipërisë? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në tërësi.

Raporti përkatës bashkë me projektligjin e zbardhur, të bëhet gati për seancën plenare të datës 18 korrik.

Nuk i thashë në fillim, por ky ligj është një nga më të rëndësishmit që ne kemi kaluar në Komisionin e Ligjeve dhe në parlament, i cili plotëson një boshllëk kushtetues, që kishim që nga viti 1998, kur u miratua Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Tashmë do të kemi një ligj të plotë për nismën ligjvënëse të shtetasve. Nisma ligjvënëse e Këshillit të Ministrave dhe e deputetëve ka qenë e rregulluar, por nisma ligjvënëse e shtetasve në Republikën e Shqipërisë nuk ka qenë e rregulluar.

Falënderoj nismëtarët e këtij projektligji, shoqërinë civile, relatorin, këshilltarët e komisionit dhe të gjithë kolegët që u përfshinë në diskutimin e këtij projektligji!

Patjetër që një falënderim shkon për Komisionin e Venecies, sepse është një praktikë pune e konsoliduar në traditën e Kuvendit të Shqipërisë, që, sa herë që kemi pasur çështje të natyrës kushtetuese në Komisionin e Ligjeve dhe në Kuvend, nuk ka munguar opinioni i këtij komisioni!

Dua të falënderoj profesoret Anastasin, që ka qenë pjesë e draftimit të këtij projektligji që sapo miratua sot. Dua të falënderoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sepse ky ligj, nesër në zbatim, është drejtpërdrejt në fokusin e këtij komisioni.

Kolegët e mi deputetë dhe mediet, ju ftoj ta pasqyroni, pasi realisht është një ligj shumë i rëndësishëm.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, 16.07. 2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10.242 datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Andi Përmeti, Elda Hoti, Aurora Mara, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi dhe Alban Zeneli

Të ftuar:

Agron Tufa – Dejtor i ISKK-së

Skënder Vrioni – Sekretar i Përgjithshëm i AIDSSH-së

Mirela Lame – përgjegjëse e Sektorit Juridik, AIDSSH

Ulsi Manja - Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës, por edhe e fundit për sot, shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore e këtij projektligji është kolegja Klotilda Bushka. Duke qenë se është projektligj i propozuar nga një grup deputetësh, në emër të nismëtarëve, paraqitjen e këtyre ndryshimeve në këtë projektligj do ta bëjë kolegu Adnor Shameti e më pas relatorja zonja Bushka, si dhe më pas do të kalojmë në pyetje e diskutime nga kolegët.

Nga Instituti i Studimeve të Krimeve kundër Komunizmit kemi prezentë zotin Agron Tufa, drejtor i ISKK-së.

Në fakt, kemi kërkuar të kishim prezentë edhe nga Autoriteti për Informimin mbi Dosjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është zoti Vrioni dhe zonja Lame.

Zoti Shameti, në emër të grupit nismëtar, ju lutem, ku konsiston ndryshimi që propozohet në ligjin nr. 10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”?

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji i propozuar synon saktësimin e periudhës së regjimit komunist në Shqipëri në funksion të qëllimit dhe objektit të këtij ligji, si dhe përcaktimin e një kriteri shtesë që duhet të plotësojnë anëtarët e bordit dhe punonjësit e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, për t’u pajisur me certifikatë sigurie të personelit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për plotësimin e kushteve për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Ndryshimet që parashikon ligji janë si më poshtë: neni 3, germa “a” ndryshohet me këtë përmbajtje: “Periudha e komunizmit është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990”.

Në nenin 3, germa “a” e ligjit në fuqi përcaktohet: “Periudha e komunizmit është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990, si dhe periudha para datës 29 nëntor 1944, gjatë së cilës është zhvilluar veprimtaria që ka përgatitur

ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila më pas u shndërrua Partia e Punës së Shqipërisë”.

Deputetët nismëtarë të këtij projektligji argumentojnë se objekti dhe qëllimi i këtij ligji është i lidhur me krimet dhe pasojat e komunizmit në Shqipëri pas çlirimit të vendit dhe jo me të gjithë periudhën që nga krijimi i forcës politike komuniste antifashiste.

Bazuar në dokumentet historike, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare arriti objektiva themelorë dhe konkretisht çlirimin e vendit dhe rivendosjen e pavarësisë kombëtare.

Regjimi komunist nuk mund të lidhet me periudhën e Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, në vijim LANÇ-i, luftë e cila u fitua me gjakun e mijëra dëshmorëve dhe siguroi pavarësinë e vendit.

Vetëm pas përfundimit të LANÇ-it, Fronti Demokratik, ku ishin të përfshirë komunistët, mori në dorë qeverisjen e vendit duke vendosur disa detyra, ndërmjet të cilave: eliminimi i kundërshtarëve politikë, qeverisja e re, hartimi i Kushtetutës, reforma ekonomike e të tjerë.

Nisur nga argumentet e nismëtarëve, periudha e komunizmit, objekt i këtij, ligji nuk mund të jetë periudha para datës 28 nëntor 1944.

Në nenin 18, pika 1 ndryshohet si më poshtë: “Nëpunësit dhe punonjësit e Institutit dhe Arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore para datës 8 dhjetor 1990, është pajisur me certifikatë sigurie personale nga DSIK-ja dhe nuk ka qenë anëtar ose kandidat i PKSH-së apo PPSH-së, i shkolluar ose nuk ka bërë kualifikime në shkollat e larta politike të Sigurimit të Mbrojtjes së Shqipërisë, a të vendeve të traktatit të Varshavës, funksionar i sistemit komunist, pjesëtar i organeve të diktaturës komuniste apo bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit, si dhe anëtar ose bashkëpunëtor i Shërbimeve Inteligjente të vendeve të Traktatit të Varshavës”.

Neni 18 i ligjit në fuqi nuk e parashikon kriterin e pajisjes me certifikatë sigurimi të personelit nga DSIK-ja për punonjësit e institutit. Nismëtarët propozojnë se për qëllimin e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore para datës 8 dhjetor 1990, është pajisur me certifikatë sigurie personeli nga DSIK-ja dhe plotëson kushtet e caktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, informacioni do t’i nënshtrohet procesit të klasifikimit, kur lidhet me plane ushtarake, armatime ose operacione; aftësi apo dobësi e kapaciteteve të sistemeve të

instalimeve, projekteve dhe planeve që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare; veprimtari të shërbimeve informative me forma dhe metoda të punës, me kriptologji në objektet dhe mjetet teknike; në vendet ku përpunohet dhe arkivat ku ruhet informacioni; informacione të qeverive të huaja, marrëdhëniet ndërkombëtare ose me veprimtari ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe me burime konfidenciale; çështje shkencore, teknologjike dhe ekonomike që kanë lidhje me sigurinë kombëtare”.

Nismëtarët argumentojnë se informacioni i grumbulluar, administruar e ruajtur në arkivin e Institutit, i dokumenteve dhe materialeve që dëshmojnë krimet e komunizmit në Shqipëri, lidhet me burime konfidenciale dhe duhet t’i nënshtrohet procesit të klasifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

Përfundimisht, në aspektin ligjor vlerësoj se projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ndërsa në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren.

Si relator vlerësoj që edhe kolegët ta miratojnë atë në parim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Fjalën e ka kërkuar zoti Alimadhi për procedurë.

Adriatik Alimadhi – E dëgjova relatorin me shumë kujdes. Relacioni që na keni bashkëngjitur nuk është i plotë, pra, ajo që lexoi zoti Shameti nuk është i plotë në informacionin që kemi bashkëngjitur.

Do të kërkoja kohën e mundshme për të na i vënë në dispozicion të gjithë relacionin të plotë, sepse kemi dy mundësi: e para, relacioni që na vendosët bashkëngjitur projektligjit dhe atë që lexoi zoti Shameti.

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, zoti Shameti prezantoi nismën duke iu referuar relacionit të nismëtarëve. Raportin në emër të komisionit do ta lexojë zonja Bushka, se është relatorja e projektligjit. Pas relatimit të zonjës Bushka, patjetër që materialin e plotë lidhur me relatimin do ta keni tani mbi tryezë edhe në variantin të printuar edhe në variantin në rrugë elektronike. Zoti Shameti prezantoi relacionin bashkëngjitur tekstit të projektligjit.

Adriatik Alimadhi – Zoti kryetar, unë mendoj se dokumentacioni u vendoset të gjithë anëtarëve të Komisionit të Ligjeve dhe që të ketë dy mundësi, unë nuk e shoh të drejtë. Është bërë mjaftueshëm politikë me këtë.

Ky është një projektligj që ka sens dhe ndjeshmëri publike, madje, ju kujtoj edhe një seancë plenare ku është debatuar rreth tij, kështu që në mënyrë që të mos i lëndojmë sërish shqiptarët, kërkoj që kjo të shtyhet dhe materialet të vendosen të qarta dhe të sakta dhe jo për të na i hedhur këtu.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Fjala për relatoren, zonjën Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Adnori bëri një sqarim të plotë të përmbajtës së nismës ligjore, ndërsa mua më duhet të prezantoj pikënisjen e kësaj nisme ligjore, nga nismëtarët, kolegët deputetë. Kjo nismë ka filluar te rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2018 dhe detyrat për vitin 2019.

Në pikën e fundit të kësaj rezolute, të miratuar nga Kuvendi në datën 23 maj 2019, thuhet shprehimisht: “Kuvendi rekomandon Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2019 të përmirësojë punën në këto drejtime: të propozojë ndryshimet e duhura ligjore, të cilat sjellin përmirësimin e punës në arkivin e punës së Institutit; në përcaktimin e detyrimit ligjor për pajisjen me certifikatë sigurie për punonjësit që punojnë me dokumente arkivore brenda dhe jashtë tij; në përcaktimin e qartë ligjor të periudhës së sistemit komunist në Shqipëri si dhe me specifikimet që lidhen me kualifikimet shkencore të domosdoshme, tituj dhe grada shkencore që duhet të kenë punonjësit e Institutit që merren me studime dhe botime”.

Pra, pikënisja e nismës së nismëtarëve ka qenë në rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Më tej, nismëtarët kanë paraqitur projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, ku në thelb propozojnë dy ndryshime, të cilat i prezantoi zoti Shameti. Njëri prej këtyre ndryshimeve ka të bëjë pikërisht me faktin e përcaktimit të qartë në nenin përkatës të ligjit aktual, i cili parashikon përkufizimet se çfarë do të nënkuptohet me periudhën e komunizmit. Bëhet fjalë për nenin 3, germa “a”.

Ndryshimi tjetër ka të bëjë me çështjen se kush do të konsiderohet “person i besueshëm” që punon në këtë Institut, sa u takon të dhënave sensitive që shqyrtohen gjatë studimeve. Bëhet fjalë për një ndryshim në nenin 18, pika 1, ku, referuar edhe kuadrit ligjor për aksesin në informacionin e klasifikuar, është sugjeruar një ndryshim: “Personat që parashikohen nga ligji aktual për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e

Komunizmit, të cilët do të merren me të dhëna që kanë të bëjnë me ato informacione, që sipas ligjit aktual konsiderohen si informacione të klasifikuara, duhet të jenë patjetër të pajisur me certifikatën e sigurisë, sipas parashikimeve të ligjit”. Nuk dua të lexoj nenet me radhë, sepse unë e kam studiuar ligjin në tërësi.

Në lidhje me çështjen e periudhës së komunizmit, ashtu siç e prezantoi edhe zoti Shameti, nëse i referohemi përkufizimit aktual të ligjit, periudha e komunizmit është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori i vitit 1944 deri më 8 dhjetor 1990. Më pas përkufizimi aktual vijon: “Si edhe periudha përpara datës 28 nëntor 1944 gjatë së cilës është zhvilluar veprimtaria që ka përgatitur ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila më pas u shndërrua në Partinë e Punës”.

Nismëtarët sugjerojnë që ky togfjalësh “si edhe periudha përpara datës 29 nëntor 1944” e në vijim të hiqet dhe të mbetet: “periudha e komunizmit është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori i 1944 deri më 8 dhjetor 1990”. Ky është një sugjerim i drejtë, prandaj mendoj të qëndroj në dy aspekte.

Në aspektin e parë, nëse i referohemi në harmoni gjithë tekstit të ligjit aktual, vëmë re që çdo detyrë e këtij Instituti, çdo funksion dhe çdo kompetencë ka të bëjë pikërisht me periudhën nga viti 1944 e në vijim dhe jo me periudhën më përpara. Po t’i marrim që nga neni ku janë përkufizimet, zoti Alimadhi, do të më dëgjoni, ju lutem, sepse më pas thoni që nuk jeni i qartë...

(Diskutime pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Nuk kam interes...

Klotilda Bushka - Nëse nuk keni interes më lejoni të jem e qetë të shpjegoj...

(Diskutime pa mikrofon)

A mund të keni mirësinë të më dëgjoni, ju lutem!

Nëse fillojmë që nga neni i përkufizimeve, aty ku flitet se cilat janë krimet e komunizmit, kush është funksionari i sistemit komunist, cilat janë organet e diktaturës komuniste, po të bëjmë një analizë të këtyre përkufizimeve dhe të shkojmë te nenet e tjera, të cilat flasin për funksionet e Institutit... Po e filloj me nenin 15, i cili flet se çfarë nënkupton arkivi i Institutit dhe çfarë aktesh përmbledh. Pra, në këtë nen flitet për akte, të cilat kanë të bëjnë me Partinë e Punës, me Frontin Demokratik ose me çdo organizatë, institucion apo strukturë tjetër që zotëron dokumente arkivore, që i shërbejnë Institutit për Studime ndaj Krimeve të Komunizmit. Sipas përcaktimit të bërë në nenin 13, pika 4, flitet prapë për çdo lloj veprimtarie, e cila, në fakt, nga një analizë fare e thjeshtë dhe vetëm duke e lexuar, i

referohet periudhës nga nëntori i vitit 1944 e në vijim jo një periudhe të mëparshme. Pra, duket që ka nevojë për një saktësim të këtij formulimi dhe jo vetëm për këtë. Ky është argumenti i parë.

Argumenti i dytë ka të bëjë me harmonizimin e ligjit. Pra, ne duhet të kuptojmë, në radhë të parë, për çfarë po flasim, që ligji në praktikë të mos jetë i paqartë dhe kjo ka të bëjë me thelbin. Objekti dhe qëllimi i ligjit aktual, në fakt, është i lidhur me krimet dhe pasojat e komunizmit në Shqipëri pas çlirimit të vendit dhe kjo është shumë e qartë, e cila del edhe nga leximi i gjithë ligjit, jo nga një nen i shkëputur dhe nuk është e lidhur me gjithë periudhën që nga krijimi i forcës politike komuniste antifashiste. Dokumentet historike kanë treguar se Partia Komuniste Shqiptare, e themeluar në vitin 1941, pati mbështetje popullore, veçanërisht me programin politik dhe me platformën për krijimin e një fronti të gjerë lufte, ku merrnin pjesë pa dallim të gjitha forcat politike. Në fakt, regjimi komunist nuk mund të lidhet me periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, por lidhet pikërisht ashtu siç është përkufizimi aktual. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare nuk mund të jetë atribut i një force të vetme politike, sepse kjo luftë është fituar me gjakun e qindra, mijëra dëshmorëve dhe nuk mundet që këtë periudhë të luftës ta lidhim me ato që quhen “krime të komunizmit”.

Ne nuk mundemi që ata që i kemi cilësuar si dëshmorë t’i lidhim në histori me periudha për të cilat themi se bëhet fjalë për krime të komunizmit, sepse, po ta lexoni ligjin në tërësi, kjo analizë del e qartë nga një lexim i thjeshtë.

E dyta, duke u nisur nga parashtrimi që kam bërë deri tani, periudha e komunizmit nuk mund të jetë para datës 28 nëntor 1944, jo vetëm sepse ngatërrojmë konceptet dhe historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me periudhën dhe krimet e komunizmit pas vitit 1944, por edhe sepse ne kemi një kuadër të tërë ligjor, i cili i rregullon këto çështje. Ne sapo kemi bërë ligjin për statusin e dëshmorëve dhe, po t’i shohim, ne duhet të harmonizojmë të gjitha dispozitat aktuale në fuqi ashtu siç janë, në fakt, edhe historia nuk mund të jetë nga ligje që dalin po nga i njëjti parlament, ndryshe në një datë dhe ndryshe në një datë tjetër.

Kjo ishte sa i takon ndryshimit të parë në përkufizimin e periudhës së komunizmit, për të cilën nismëtarët sugjerojnë të jetë nga 29 nëntori i vitit 1944 deri më 8 dhjetor të vitit 1990, siç e ka edhe ligji, duke e fshirë pjesën tjetër, si dhe periudha para datës 29 nëntor të vitit 1944 e më parë. Pra, të ngelet 29 nëntor 1944 deri në dhjetor 1990.

Sa i takon pjesës tjetër, që ka të bëjë me pajisjen me certifikatë sigurie, ndoshta mediet e kanë transmetuar dhe një pjesë e atyre që janë të pranishëm këtu e mbajnë mend, ne kemi bërë një vizitë në kuadër të kontrollit parlamentar tek Autoriteti i Hapjes së Dosjeve. Ne

si Komision i Ligjeve e kemi kuptuar se sa sensitive janë arkivat që ky institucion menaxhon, si dhe arsyet përse zbatohen me rigorozitet të gjitha rregullat e ruajtjes së informacionit sekret, duke qenë dëshmitarë në vizitën që u organizua.

Pra, vizitat që ne organizojmë nëpër institucione i shërbejnë pikërisht përmirësimit të punës sonë, por edhe institucioneve, që nëpërmjet kontrollit parlamentar të merren nisma për rishikim legjislativ. Shoh që përfaqësuesit e institucionit po e miratojnë këtë që sapo ju thashë, pasi kemi qenë së bashku kur kemi parë se sa e nevojshme është që jo vetëm kushtet të jenë të sakta...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, pak respekt, sepse jemi në sallën e Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë!

... jo vetëm që të ruheshin, por edhe të tregohej kujdes gjatë punës me dokumentet arkivore, por edhe se sa të besuar duhet të ishin personat që merreshin me këto informacione. Neve, kur na u desh të hapnim një dosje për të kuptuar se si funksiononte puna, na u bë e qartë pyetja nëse i kemi apo jo dokumentet përkatëse për të parë një informacion të caktuar.

Pra, duke iu referuar ligjit, pa përsëritur atë që paraqiti kolegu Shameti, legjislativi aktual për informacionin dhe dokumentet sekrete parashikon në mënyrë të qartë se cilat janë ato dokumente për të cilat para shqyrtimit apo aksesimit të tyre duhet të pajisesh me një dokument të caktuar. Informacionet, për të cilat Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit të marrë në shqyrtim përbëjnë ato informacione, të paktën për atë pjesë që u referohet arkivave të autoritetit të dosjeve, që është i pranishëm këtu, të cilat në pjesën më të madhe të tyre janë të klasifikuara si sekrete, prandaj duhet patjetër që personat që i aksesojnë të kenë një certifikatë sigurie. Ne jemi anëtarë të Komisionit të Ligjeve dhe marrim pjesë nëpër komisione hetimore, por ne nuk mundemi dot të aksesojmë asnjë dokument të vetëm kur ligji e parashikon që ai dokument shihet vetëm nëse personi është një person i pajisur me certifikatën përkatëse. Unë mendoj se kjo është një çështje e drejtë e sugjeruar nga kolegët tanë deputetë në nismën ligjore dhe shpresoj që ju do të më mbështesni edhe në këtë pikë.

Në tërësi, duke vlerësuar që projektligji i paraqitur nga kolegët deputetë, në vijim të rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në maj të vitit 2019, është i bazuar në ligj dhe vjen në përputhje me të, gjithashtu ka edhe një arsye racionale përse është propozuar, ju ftoj ta mbështesni dhe ta votoni.

Jam e hapur për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve që ju do të keni.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

(Diskutime pa mikrofon)

Fjalën e kanë kërkuar të gjithë, por duhet të përcaktojmë një radhë.

I pari e ka kërkuar fjalën nënkryetari i Komisionit të Ligjeve, zoti Lita, në emër të grupit.

(Diskutime pa mikrofon)

Artur Roshi – Unë kam bërë një relacion dhe jua kam dërguar. Në këtë relacion kam argumentuar të kundërtën, prandaj më duhet ta lexoj dhe më pas të vazhdohet me pyetjet dhe diskutimet.

Ulsi Manja – Jo.

Artur Roshi – Si jo? Në fillim bëhen pyetjet dhe diskutimet dhe nga fundi...

Ulsi Manja – Jo nga fundi. Ju jeni deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe keni të drejtën të përfshiheni në një diskutim aktiv sa i takon këtij projektligji, por nuk keni të drejtën e votës si kolegët e tjerë të komisionit...

Artur Roshi – Kush jua tha këtë?

Ulsi Manja – Unë do t'ju jap fjalën sapo nënkryetari i komisionit të mbarojë fjalën e tij dhe më pas do ta merrni ju.

Artur Roshi – Kjo nuk ka fare logjikë.

Ulsi Manja – Ka shumë logjikë...

Artur Roshi – Amendamenti, kundëramendamenti, të cilat jua kam dërguar para 1 jave...

Ulsi Manja – Kur ta marrësh fjalën, mund të bësh edhe propozimin konkret. Ku qëndron problemi këtu?

Artur Roshi – Relatori mbajti qëndrimin e tij, tani është kundërqëndrimi dhe më pas të vazhdohet me pyetjet dhe diskutimet...

Ulsi Manja – Po ka edhe ky kundërqëndrim, edhe ai atje ka kundërqëndrim, nënkryetari i Kuvendit që është i pranishëm në komision, edhe zoti Përmeti ka kundërqëndrim...

Artur Roshi – Pas meje, more zotëri...

Ulsi Manja – Këtë pjesë e ka përcaktuar Rregullorja, të lutem!

Artur Roshi – Rregullorja duhet të jetë me logjikë...

Ulsi Manja - Ky nuk është debat.

Zoti Lita, mund të vazhdoni.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë mendoj se iniciativa për ndryshimin e këtij ligji nuk është bërë për efekt të përmirësimit të punës, siç e tha edhe zonja Bushka në fjalën e saj, të këtij institucioni, por si ego e debatit midis drejtuesit të këtij institucioni dhe disa eksponentëve, ish-drejtues dhe zyrtarë të periudhës së komunizmit, të cilët janë identifikuar si persona që kanë abuzuar me ligjin në shkelje të të drejtave të njeriut gjatë sistemit komunist.

Sa u përket neneve konkrete, unë mendoj që çështja shtrohet në dy pika.

E para, periudha e komunizmit. Ne të gjithë e dimë që periudha e komunizmit si sistem politik është 1944-1990, por në rastin konkret Instituti ka si objekt studimi krimet e komunizmit. Në këtë këndvështrim çdokush e di...

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Alimadhi dhe zoti Hyseni, ju lutem, më lini ta mbaroj fjalën, sepse unë nuk flas shpesh që t'ju shqetësoj.

(Diskutime pa mikrofon)

...që sistemi komunist, pra Partia Komuniste e ka filluar aktivitetin e saj...

(Diskutime pa mikrofon)

...terrorist që në nëntor të vitit 1941 fillimisht, duke...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, në pushtet erdhi me terror, pra janë dy gjëra krejt të ndryshme.

...eliminuar jo vetëm kundërshtarët politikë të partisë, por edhe kundërshtarët e vijës politike brenda partisë.

Pra, në aspektin studimor mendoj se periudha e studimit për krimet e komunizmit është 1941-1990.

Së dyti, e cila është më e rëndësishmja, duket sheshit që ky është një produkt i një konflikti personal, e zotit Braho me drejtuesin e institucionit.

Po të shihni me kujdes propozimin për ndryshim të nenit 2, kërkohet që punonjësit dhe drejtuesi i institucionit duhet të pajisen me certifikatën e sigurisë.

Të nderuar kolegë,

Instituti i Studimeve të Krimeve kundër Komunizmit është institut studimor, objekti i punës së tij është mbledhja e dokumentacioneve, fakteve për studimin e një çështjeje të caktuar. Ky institut nuk ka asnjë lidhje me çështje që lidhen me çështje shtetërore. Për efekt të punës ky institut zyrtarisht kërkon informacione nga më të ndryshmet, për shembull, nga Autoriteti i Dosjeve. Me këtë rast do të pyesja përfaqësuesit e Institutit të Dosjeve, ku

ndryshon kërkesa zyrtare e një personi që ka certifikatë sigurie nga ai që nuk ka certifikatë sigurie? Unë mendoj se ata kanë një ligj funksionimi, sipas të cilit, nëse nuk lejohet të jepet informacioni, nuk i jepet as atij që ka, as atij që nuk ka. Pra, ata mund të kërkojnë informacion nga Autoriteti i Dosjeve, Shërbimi Informativ, Biblioteka Kombëtare, Akademia e Shkencave, KGB-ja, sepse e kanë merak shumë këto, sepse ka lidhje edhe ajo, CIA. Pra, për të gjitha këto institucione Instituti ka vetëm të drejtën e kërkesës së informacionit. Këto institucione kanë ligjin e tyre të funksionimit dhe nuk bien ndesh me sigurinë ose pajisjen me certifikatë sigurie. Gjithçka që përbën sekret dhe nuk lejohet ata nuk e japin. Pra, del qartë se ky institut nuk merr dot informacion, të cilat janë sekrete dhe duan certifikatën e sigurisë. Pra, certifikata e sigurisë nuk është e nevojshme për punonjësit e këtij institucioni. Nëse e shikojmë në planin e një debati profesional Braho- Tufa, do të ishte më e ndershme që në projektligj të vendosej vetëm një nen të largohet Agron Tufa. Besoj kjo do të ishte shumë më e ndershme dhe e kuptueshme për publikun.

Grupi Parlamentar Demokrat edhe në komision, edhe në seancën plenare janë kategorikisht kundër këtij ndryshimi ligjor, sidomos nenit për pajisjen me certifikatë sigurie. Është turp që konflikti personal të vërë në lëvizje jo vetëm Komisionin e Sigurisë, por të gjithë parlamentin shqiptar.

Ulsi Manja- Po, faleminderit, zoti Lita!

Zoti Roshi.

Artur Roshi- Zoti Manja, unë para një jave ju kam depozituar një relacion argumentues bazuar mbi fakte, të cilin mendoj se, nëse të gjithë deputetët do ta kishin, edhe ata që e kanë propozuar...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Jo, me ligj nuk e kanë, por nuk ka rëndësi.

Kam bindjen që tendenca ime është që ne t'i bindemi logjikës, nuk është tendenca.

Në një iniciativë të zotit Spartak Braho, mbështetur nga 9 deputetë të tjerë të Partisë Socialiste, kërkon ta amendojë ligjin për Institutin e Studimeve të Krimeve Kundër Komunizmit, por në lidhje me ndryshimin e periudhës së studimit të tij amendamenti thotë: “Periudha e studimit të komunizmit të ndryshojë jo që nga krijimi i Partisë Komuniste 8 nëntor 1941-1990, por që nga 29 nëntor 1944 deri në vitin 1990”. Thelbi i arsytimit të këtij amendamenti, sipas zotit Braho dhe deputetëve propozues, është se Partia Komuniste në programin e saj të shpallur nuk shtronte kryerjen e revolucionit socialist, diktaturën e proletariatit ose luftën e klasave, por shtronte çlirimin e vendit, ndërtimin e një rendi

demokratik në Shqipëri. Pra, ky është thelbi i atij argumentimit që ata kanë bërë. Sipas meje iniciativa të tilla nuk kanë drejtim logjik dhe asnjë lloj produkti për Shqipërinë. Ne, duke studiuar krimet e komunizmit, izolojmë, në fakt, filozofinë e Marksit nga e cila merr jetë komunizmi dhe kjo duhet bërë sa më parë.

Ne nuk duhet të biem në nivele të tilla se komunizmi si ideologji ishte i mirë, ndërsa zbatimi i tij ishte i keq. Filozofia marksiste ka në thelb të saj goditjen e besimit fetar, të pronës, të familjes, të moralit shoqëror, goditjen e vlerave. Të gjitha këto i njektin nëpërmjet dhunës së intrigës malinje në mendjet njerëzore. Që në momentin që e institucionalizon këtë filozofi nëpërmjet Partisë Komuniste, ke institucionalizuar dhunën dhe krimin si rrjedhojë e saj. Partia Komuniste e njësoi termin “partizan” me “komunist” dhe në këtë mënyrë partizanët e vërtetë që donin të luftonin për lirinë e vendit, i kthyen në viktime të pushtetit të tyre duke rrëmbyer konotacionin e patriotizmit të tyre.

Ulsi Manja- Ju lutem!

Artur Roshi- Ju lutem unë ju!

Ulsi Manja - Kjo është deklaratë dil te argumenti.

Artur Roshi- Po zonja na bërë histori partie gjysmë ore tani.

Ulsi Manja- Ju lutem dil tek argumenti.

Artur Roshi- Jo, nuk ma tregon ti se kur të dal unë te argumenti.

Ulsi Manja- Mbledhjen e drejtoj unë, jo ti.

Artur Roshi- E drejton ti, por Kuvendi është i shqiptarëve.

Ulsi Manja- Po, unë do ta ndërpres fjalën.

Këto gjëra i ka Agroni, si studiues.

Artur Roshi – Dëgjoni logjikën! Ne duhet të ngremë shoqëri me ideale të vërteta dhe jo me të vjedhura. Nëse quajmë dhunë një fishekzjarr që lëndon brenda një kufiri jetësor, si mos të quajmë dhunë vrasjeje atë të Partisë Komuniste? Pse në të gjithë botën kjo ideologji sollti krime të panumërta ndërsa në vendin tonë jo? Enver Hoxha startoi në pushtet si një gjeneral duke ngritur një diktaturë me qeverisje absolute të një individi njëlloj si rasti i diktaturës së Francesko Frankos në Spanjën e vitit 1936 pas një lufte civile dhe më vonë në vitin 1948 e përshtati atë me një diktaturë të proletarietit, sipas konceptit marksist qeverisjen e klasës punëtore dhe shoqëri pa klasa duke ndërruar vetëm emrin nga Parti Komuniste në Parti e Punës. Mohimi i studimit të krimeve të komunizmit sot është një amendament që bën legalizimin e tyre. Askush sot qoftë edhe deputet nuk ka tagrin e legalizimit të krimeve të një periudhe të ngatërruar. Nëse do të fshihet kjo periudhë kohore në studimet e këtij instituti,

kush do t'i studiojë krimet e kësaj periudhe? Ne themi se duhen studiuar, ku është e keqja këtu që të mësojmë nga e shkuara? Me përkufizim “veprim politik” është një përpjekje për të zgjidhur konfliktet përmes një vendimi të detyrueshëm për të gjithë, por karakteri detyrues i vendimeve nuk është arbitrar, por mbështetet në një tërësi rregullash dhe modelesh të pranuar nga komuniteti. Ku është e keqja këtu? Ky është thelbi i ligjit.

Referencat e argumenteve. Nuk po marr për referencë historianin Uran Butka në librin “Dritë hijet e historisë” në faqen 94 flet për një luftë të pastër civile të filluar nga komunistët pas Konferencës së Labinotit të mbajtur në 4-8 shtator të vitit 1943. Pavarësisht se hyn te historianët që kanë bërë një studim të thelluar dhe serioz të arkivave, sepse babai i tij ka qenë personalitet i organizatës së Ballit, pra i kundërshtarëve politikë të komunistëve, nuk po e marr në referencë, por po filloj me librin e Blendi Fevziut “Enver Hoxha”. Në periudhën nëntor 1944, në faqen 79, me porosi të Titos Llazar Fundo...

Ulsi Manja- Ju lutem, mos ma ulni seriozitetin e mbledhjes së komisionit. Ne jemi për diskutimin e projektligjit jo të historisë së Shqipërisë.

Artur Roshi – Po mbi çfarë e bën projektligjin ti? A nuk e bën mbi bazën e historisë?

Ulsi Manja– Ju lutem, zoti Roshi, ju mungojnë tribunat, por kjo nuk është tribunë.

Ju lutem, fjalën e ka zoti Hyseni.

Artur Roshi – Këto janë argumente. Kam marrë referenca nga Fevziu, Kadare. Këto janë referencat që duhet të marrim ne.

Ulsi Manja – Agron Tufa ka shkruar 10 libra për këtë punë. Ju lutem, më flisni për argumentin ligjor!

Artur Roshi – Këto janë argumente.

Ulsi Manja- Këto vetëm argumente ligjore nuk janë.

Artur Roshi – Në rregull, kjo është pjesa kryesore, në fakt. Damian, e kemi parë sa i koncentruar ke qenë.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Roshi, flisni për ligjin.

Artur Roshi- Unë e kam marrë seriozisht, kam lexuar libra dhe kam ardhur me referenca studimore. Ku është problemi këtu?

Sot në ditët tona shoqëritë e përparuara luftojnë dhe vetë lufta si koncept është burim i pafundëm pikëpyetjesh për dobinë, pasojat dhe legjitimitetin e saj për çështjet kur është moralisht i vlefshëm përdorimi i dhunës dhe kur jo. Pse të mos i studiojmë krimet? Kush

përfiton nga mosstudimi? Askush? Kush përfiton nga studimi i tyre? Fëmijët tanë, qofshin komunistë, qofshin ballistë.

Ulsi Manja- Po ta studiojnë.

Artur Roshi- Po ju nuk doni pra.

Ju e përcaktoni.

Ulsi Manja- Po hapini dokumentet. Krimi ka vepruar pas viteve 44 dhe nuk ka vepruar para?

Po lexo edhe para 44-ës ti!

Artur Roshi- Por po e ndalon ti, pra me ligj, zotëri.

Sa i përket certifikatës, thoni që duhet për të gjithë punonjësit e institutit dhe të arkivit.

Ulsi Manja- Lëreni, zonja Bushka, se është historian.

Artur Roshi- Jo, nuk jam historian.

Artur Roshi- Nuk jam historian, por lexoj më shumë se ti. Unë jam kurioz dhe lexoj.

Marrim një institut tjetër analog, atë të Historisë. Pse Institutit të Historisë nuk i kërkon certifikatën? Çfarë sensi ka këtu? Marrim si shembull rastin e një studenti, i cili kërkon të studiojë, por ti i thua se duhet të jetë me grada, duhet të ketë ca certifikata. Kush ia jep këtë besueshmëri? Pra, besueshmëria këtu, siç ne jemi mësuar deri sot, është thjesht për të lënë pasiv disa njerëz që duan të studiojnë realisht. Unë them se ky projektligj duhet rrëzuar dhe ky amendament le të qëndrojë si një ëndërr e papeshuar mirë e zotit Braho.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Ju lutem, të dëgjojmë njëri-tjetrin se edhe historinë e keni bërë lëmsh. Lëreni historinë të studiohet nga historianët!

Artur Roshi- Unë them ta lexojmë ta studiojmë, por ju doni ta ndaloni. Pse duhet ta ndaloni?

Ulsi Manja- Zoti Hyseni.

Adriatik Alimadhi- Në fakt, ju thatë, kush ka pyetje, por filluat me diskutime. Unë mendoj të vazhdojmë me pyetjet.

Ulsi Manja- Po, faleminderit, zoti Alimadhi!

Qëndron vërejtja juaj, por jemi të gjithë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe të gjithë e dinë se kur është faza e pyetjeve dhe e diskutimeve. Këtu ka deputetë që i bashkojnë fazat në një, edhe pyetjet, edhe diskutimin, edhe qëndrimin politik, por unë dua t'i rri strikt

rregullit. Prandaj, fjalën e ka zoti Hyseni, nëse ka pyetje, mund t'i bëjë, nëse jo, mund t'i përmbledhë të dyja në pyetje dhe diskutime.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ne po bëjmë një ndryshim fare të vogël në një ligj, i cili i ka dhënë efektet e tij prej vitesh dhe nuk e kuptoj shqetësimin e shumë kolegëve, të cilët nuk duhet të abuzojnë me të drejtat demokratike. Ata nuk duhet të bëjnë të njëjtin gabim sikurse paraardhësit e tyre. Unë jam krenar që kam firmosur këtë, ashtu siç jam krenar që mbështes kauzën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam krenar që jam pasardhës partizanësh, të atyre njerëzve që, jo vetëm partizanët, por edhe me plot nacionalistë të tjerë, u renditën në frontin më të madh antifashist që historia botërore ka njohur. Unë jam krenar, sepse ata në një moment të vështirë të historisë e renditën Shqipërinë tonë të dashur në krahun e duhur të kësaj historie. Prandaj jam krenar dhe nuk mund të lejoj askënd që të baltosë dhe të bëjë pis atë epopë të madhe të popullit shqiptar. Të mos harrojnë këta zotërinj se Shqipëria, pavarësisht se ishte në komunizëm, nuk ka bërë asgjë tjetër përveçse zbatimin e kartave ndërkombëtare për luftë të pakompromis kundër kolaboracionistëve. U kujtoj zotërinjve se çfarë ka bërë Franca...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, dëgjoje ti dhe përcillja gjyshërve të tu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë u kujtoj kolegëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja -Ju lutem, zoti Hyseni, të kalojmë te projektligji!

Alket Hyseni – Meqë u morët me histori, jua tregoj unë historinë!

Ulsi Manja- Zoti Hyseni, ju lutem, përfundojeni fjalën tuaj, sepse do të kalojmë në votim!

Alket Hyseni – Pse ka dalë ky ligj?! Ky ligj ka dalë, sepse që nga viti 1945 e mbrapa ka pasur vërtet abuzime. Edhe pse një pjesë e mirë e atyre që luftuan kishin një ideal të pastër dhe kishin ëndrra për një Shqipëri të lirë e moderne, pati abuzime qoftë doktrinare, qoftë edhe zbatime të gabuara të ligjeve penale, të cilat sollën si pasojë internime dhe persekutime me të padrejtë të mijëra familjeve dhe për këtë arsye shoqëria jonë, si një shoqëri moderne, nxori këtë ligj si një formë minore të kërkimit të ndjesës, por ne nuk duhet të ngatërrojmë veprimin e ligjit dhe moralit të një populli kundër atyre që bashkëpunuan me fashizmin, sikurse bënë

në Francë. Në Holandë deri në vitin 1950 u arrestuan dhe u dënuan 200 000 vetë për bashkëpunëtorë të fashizmit, në Norvegji 92 000 të arrestuar kundër kolaboracionistëve, në Danimarkë 20 000 veta, deri në Luksemburgun e vogël 10 000 të arrestuar si kolaboracionistë. Ju nuk mund t'i bëni bashkë ata që u internuan pa të drejtë me ata që bashkëpunuan me fashizmin dhe nazizmin. Nuk mund t'i bëni bashkë, duke ngatërruar vitet e luftës dhe të epopesë. Nëse dikush ka qejf mund t'ju recitoj një varg të Shefqet Musarajit, por ju kërktoj të ruani moralin e këtij komisioni dhe të mos lejojmë debat historie, sepse historinë e kanë bërë me gjak 28 000 dëshmorë dhe duhet të keni respekt ju, ne dhe kushdo tjetër.

Ulsi Manja– Zoti Murrizi, ju lutem, fokusohuni te dy nenet që propozohen për ndryshim te ligji. Në komision funksionon mekanizmi i votës. Sigurisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, ju jeni i ftuar këtu dhe duhet të keni pak respekt për kolegët e komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dil në korridorin e Kuvendit dhe fol para mediave gjithë ditën.

Ulsi Manja- Zoti Murrizi, ju lutem, fokusohuni te projektligji dhe t'i shmangim debatet e historisë, sepse nuk shterojnë këtu, ato do të vazhdojnë deri sa të ekzistojë Shqipëria dhe kombi shqiptar!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të përpiqem të përmbledh dyshimet e mia rreth projektit dhe një diskutim të shkurtër sesi e shoh unë këtë projektligj.

Së pari, që të jem i sinqertë, neni 2 i këtij projektligji është një nen që do ta kisha zili dhe sot do ta firmosja me qejf së bashku me të gjithë deputetët e opozitës nëse ky nen do të ishte për politikën shqiptare, për të gjithë të zgjedhurit, të emëruarit në poste e larta që kanë qeverisur Shqipërinë dhe që do ta qeverisin Shqipërinë. Nuk ka nen më ekselent sesa ky, të cilin ia kam kërkuar edhe Autoritetit të Dosjeve, edhe atyre që kërkojnë të bëjnë histori dhe na mbajnë fjalime, që m'u bë mishi kokrra- kokrra dhe m'u duk vetja si me 5 Maj me shall pionieri në qafë. Neni 2 thotë: “Nëpunësit”, unë propozoj që të heqim fjalën “nëpunësit” dhe ta bëjmë deputetët, ministrat, kryeministrat, zëvendësministrat, drejtorët e përgjithshëm dhe të gjithë ata që punojnë në shtet, edhe Presidentin. Ky nen është fiks ai që ndan shapin nga sheqeri, që ndan llumin e shoqërisë me atë që i takon të qeverisë Shqipërinë në 29 vjet post komunizëm. Po të keni këllqë dhe po të keni kurajë, e bëni këtë. I përgëzoj zotin Braho, zotin Shameti dhe të gjithë iniciatorët për këtë. Silleni ta firmos unë dhe ta zgjerojmë diapazonin e këtij ligji për politikën shqiptare. Çfarë thotë ky nen?! Atë që nuk kanë guxuar kurrë memecët

politikë dhe spiunët e sigurimit të shtetit, të cilët kanë zaptuar 140 karriget e parlamentit, ata që kanë qeverisur Shqipërinë që nga 31 marsi i vitit 1991. Pse nuk e kanë bërë këtë?! Sepse ua kanë shitur shpirtin dreqit, kanë ngrënë një lugë çorbë, kanë vjedhur gjithë jetën dhe parmbremë i pamë në një shfaqje të pështirë të një bllokmeni që bëri një libër dhe i kishte sjellë si qenë verdallë për të treguar të gjitha që ka bërë ky Bllok në 45 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk jam kopil Blloku unë.

Nëse doni ta bëni këtë ligj, ne politikanët, deputetët, ne që jemi këtu, që bëjmë moral dhe u shesim dëngla qytetarëve, nuk duhet të kemi qenë spiunë të Sigurimit të Shtetit, nuk duhet të kemi qenë oficerë të Sigurimit të Shtetit, nuk duhet të kemi qenë anëtarë të PPSH-së dhe PKSH-së, nuk duhet të kemi qenë të shkolluar në shkollat komuniste të sigurimit të Bashkimit Sovjetik, nuk duhet të kemi qenë funksionarë të sistemit komunist dhe pjesëtarë të organeve të diktaturës komuniste dhe nuk duhet të jemi bashkëpunëtorë të shërbimeve inteligjente të vendeve të traktatit të Varshavës. Po të kemi këllqe e bëjmë për politikën, lajmë fytyrën pas 29 vjetësh, u themi shqiptarëve se kë kap ky ligj dhe i lëmë dënglat, jo vetingu, jo ta bëjmë paradite, jo pasdite. Po ta bëjmë këtë nen të këtij ligji, jo për Agron Tufën, por politikën shqiptare, do të keni mbështetjen time. Hajdeni të ndryshojmë edhe sistemin zgjedhor, ikim nga Kuvendi dhe të zgjedhin vetë shqiptarët kë të duan. A jeni burra?! Nuk jeni, sepse jeni të bërë pis. Vetëm 8 deputetë kanë guxuar të shkojnë tek Autoriteti i Dosjeve dhe të marrin vërtetim nëse kanë qenë ose jo këlyshë të Sigurimit të Shtetit. Pse nuk shkoni ju të tjerët?! Shkoni atje, ja ku e keni Genta Sulën, e cila po ju pret krahëhapur. Pse po ju pret?! Sepse ata që kanë qenë këtu kanë bërë një ligj legen, ligj që kush ka këllqe të shkojë. A kanë këllqe spiunët të shkojnë?! Le të shkojnë, bujrum, kush ua ka ndaluar? Naftën për atje ua paguaj unë, 2 mijë lekë të vjetër për letër ua jap unë. Pra, po ta kemi këtë nen për politikën do t'i kishim bërë një shërbim të mirë kombit.

Ulsi Manja- Zoti Murrizi, ju lutem, Kodin e Etikës së Sjelljes!

Myslim Murrizi- A ka njerëz këtu nga DSIK-ja, sepse dua t'i pyes se si mund të besoni se certifikatën e sigurisë në DSIK do ta japë Mark Ndreca, 11 vjet ish-oficer sigurimi, që punon atje, do ta japë Agim Cani, ish-oficer sigurimi?! A doni t'i japim moral ligjit?! Për kartonë e keni hallin?! I keni kartonët, ka tërmet këtu sa të duash. Me 74 oficerët e sigurimit që keni në Shërbimin Informativ do të jepni certifikatë sigurie, me 519 që keni në polici, me 10 veta që keni në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë apo me 3120 vetë që keni në të gjithë administratën e shtetit? Nëse doni që t'i qërojmë, këtë nenin këtu..., ndërrojani emrin këtij

ligji dhe nuk ka më të shkëlqyer se ky, por ta bëjmë për këta që vjedhin lekë, u bëjnë moral shqiptarëve dhe shesin dëngla prej 29 vjetësh që gjoja luftojnë komunizmin dhe kur i thërret me bilbil Allamudhi shkojnë për një pjatë çorbë atje. Për këtë kam ardhur unë këtu, nuk kam ardhur për Agron Tufën, sepse ai është i zoti vetes dhe, nëse nuk punon aty, do të punojë në një vend tjetër.

Zoti kryetar, sa deputetë kanë certifikatë sigurie në komision?

Ulsi Manja – Të gjithë.

Myslim Murrizi – Sa kanë në parlament?

Ulsi Manja- Nuk e di, nuk e kam idenë, sepse është individuale.

Myslim Murrizi- 31 deputetë. Ti i kërkon shoferit të Agron Tufës certifikatë sigurie kur nuk e kanë 120 deputetë?! Kjo është hipokrizi.

Keni marrë nismë për të shkarkuar Ilir Metën, rruga e mbarë ju qoftë; mbrëmë dëgjova se do të shkarkoni Arben Malajn, sot dëgjova për dikë tjetër. Kaq i ngeshëm qenka ky parlament që në seancën e fundit do të bëjë një ligj me patjetër për të hequr njerëz nga puna?! Kjo është kosto, vetëm me fletët që kemi shtypur këtu mund t'i kishim dhënë rrogën Agron Tufës dhe do ta kishte dhënë vetë dorëheqjen. Kur t'ju mbushet mendja se këtë nen do ta bëjmë për politikën... Shkruaje, zoti kryetar, sepse as ti nuk ke qenë spiun...

Ulsi Manja – Nuk më lidh mosha.

Myslim Murrizi – Nuk ka lidhje mosha, sepse janë rekrutuar që 16 vjeç, edhe Jari 16 vjeç ishte, “Venusi”. Ndërroje, sepse je kryetari i komisionit që kalon në dorë ligjet që hartojnë dhe votojnë deputetët. Bëjeni për politikën këtë ligj që ta votojë me qejf! Mos bëni cicla-micla! Hajdeni të bëjmë ligj që t'i vëmë veshin **katruhdës**, sepse kështu e kemi terezinë në këtë moment.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Murrizi!

Në fakt, këtu nuk jemi për zotin Tufa, por për të rregulluar me ligj që të mos baltoset një periudhë shumë e ndritur e Shqipërisë, që na renditi në koalicionin botëror kundër fashizmit.

Nëse zoti Tufa,...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse instituti i zotit Tufa do ta bëjë siç duhet detyrën për ta studiuar siç duhet periudhën e komunizmit '44-'90, edhe këta 130 spiunët dhe bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit, sot do të ishin me emra dhe mbiemra dhe nuk do të ishin në administratë. Po shkove

të merresh me partizanët, të cilët kanë derdhur gjakun për këtë vend dhe të shkruash libra '41-'44 dhe të bësh kriminelë partizanët, të cilët kanë dhënë jetën e i kanë dhënë shpirtin popullit, patjetër që do të merremi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj ka spiunë të Sigurimit të Shtetit sot në administratë, sepse ky instituti duhet të rrijë fiks te ligji...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam shumë dakord me ju, zoti Murrizi, që të dyja nenet, të cilat propozohen, të diskutohen teknikisht. Edhe unë nuk e kam ftuar kot këtu Autoritetin e Hapjes së Dosjeve, por që t'i pyes teknikisht nëse duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie punonjësit e Institutit të Studimeve të Krimeve të Komunizmit apo nuk duhet të jenë, sepse unë jam ligjvënës, nuk jam historian. A vlen për institutin ligji "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", sepse, në fund të fundit, ky është studiuës? Ai mund të kërkojë edhe në arkivat e FBI-së materiale, por ai i thotë që nuk ia jep materialin, se është informacion i klasifikuar, por kjo nuk është në përgjegjësinë e Agron Tufës. Prandaj unë sot i kam kërkuar Autoritetit të Hapjes së Dosjeve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam jurist.

Zotërinjtë e Autoritetit kanë dokumentacionin, kanë arkivat e 30 milionë dokumenteve të periudhës komuniste dhe, normalisht, duhet të na e thonë, sepse nuk është patjetër qëllim në vetvete...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë dy nene që propozohen: është neni 1, ku kërkohet të bëhet një ndryshim te periudha e studimit të komunizmit dhe patjetër që do ta bëjmë, sepse është rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë. Ajo është votuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Pjesën e dytë, ku propozohet për pajisjen me certifikatë sigurie, që të mos e kufizojmë veprimtarinë e punës studimore të institutit, hajdeni ta diskutojmë ligjërisht, por jo me konsiderata politike.

Agron Tufa – Zoti kryetar, mendoj se procedura po hyn në një rrugë pa krye, për shkak se në relacionin e ligjit, që kanë përgatitur deputetët e nderuar, në pikën e fundit thuhet: "Institucioni që ngarkohet për zbatimin e këtij projektligji është instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, si dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar". Vetvetiu dhe rrufeshëm lind pyetja: a ndodhen këtu përfaqësues të DSIK-së?

A ka ndonjë raport të tyre këtu, sepse ata janë pala që do ta realizojnë? Është krejtësisht jashtë loje Autoriteti i Informimin për Dosjet e Sigurimit të Shtetit. Në qoftë se nuk ka një raport të tyre dhe prani të tyre, unë propozoj që kjo mbledhje të shtyhet.

Ulsi Manja – Zoti Tufa, kjo mbledhje nuk shtyhet.

Ligji që kemi përpara, është në fuqi, propozohet ndryshim i dy neneve, i nenit 3 dhe i nenit 18, por, në fakt, ligji ju ngarkon ju për zbatimin e këtij ligji dhe jo Drejtorinë...

Agron Tufa – Edhe DSIK-në. E keni shkruar vetë.

Ulsi Manja – Për certifikatën, nëse do të miratohet neni 2, sipas propozuesve, patjetër që do të ngarkohet edhe Drejtoria e Informacionit të Klasifikuar, por nuk kemi shkruar te kjo pikë.

Agron Tufa – Preket ligji nr. 8457 i DSIK-së.

Ulsi Manja – Nëse do të miratohet neni 2, sipas variantit që kanë sjellë propozuesit, patjetër që do të preket edhe ai ligj, por ne nuk kemi shkruar tek ai nen.

Agron Tufa – Në rregull, do ta diskutojmë më pas.

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Përmeti, më pas zonja Mara.

Pastaj kalojmë tek objekti konkret i projektligjit.

Andi Përmeti – Për të qenë i sqartë, duke qenë se kam vlerësim për pjesën juridike dhe për personat, që janë juristë shumë të mirë në këtë komision, përveç një emri, më bënë përshtypje firmëtarët e këtij projektligji, por më bëri habi edhe mbrojtja që i bëri zoti Hyseni.

Gjithsesi, kam disa pyetje dhe një diskutim të shkurtër, të cilin nuk e kam politik.

Neni 1, që ndryshon periudhën e komunizmit, më poshtë në relacion thuhet: “8 nëntor ’41 fitoi mbështetjen popullore, veçanërisht me programin politik”. E marrim të mirëqenë, po çfarë të keqeje ka ta studiosh nëse ka pasur krime komunizmi në atë periudhë?! Në fund këtu thuhet “për Institutin e Studimeve” dhe jo për institutin e dënimeve. Domethënë, ajo parti që fitoi mbështetje, që bëri edhe atë luftë dhe shumë veta nuk kanë asnjë faj dhe kanë meritë në atë kohë, por ka edhe nga ata që mund të kenë bërë krime. Çfarë të keqeje ka ta studiojmë? Pse duhet ta ndalojmë studimin me ligj?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Së dyti, në nenin 2 thuhet...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Unë jam totalisht dakord me zotin Murrizi, por jo me këtë nen këtu. Kjo është në rregull për politikanët dhe për personat e tjerë, që bëjnë moral nga mëngjesi në darkë para

këtyre mikrofonave, por jo për ata, që punojnë për të marrë një rrogë, sepse, në fund të fundit, nuk kanë gjë në dorë.

Gjithsesi, kam një pyetje që më shqetëson. Thuhet: “Nëpunësit dhe punonjësit e institutit të arkivit duhet të jenë persona që tregojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore para datës 8 dhjetor '90”. Po pse unë, që e kam mbushur më pas, nuk i jam i besueshëm për atë që ka bërë këtë ligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e ka të ndarë. Thuhet: “Për qëllimet e këtij ligji i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore para datës 8 dhjetor '90”. Kështu që edhe unë jam, sipas këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto ishin pyetjet e mia, pra ndoshta janë formuluar pak keq, kurse për pjesën e parë...

Ulsi Manja – Ju lutem, relatorja një përgjigje, sepse nismëtarin nuk e kemi këtu!

Më pas fjalën e ka zonja Mara për pyetje.

Klotilda Bushka – Për pyetjen e parë që thoni: çfarë të keqeje ka që ta studiojmë edhe periudhën më parë

Po flasim për ligj, nuk po flasim për një libër historie. Në ligj Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit studion krimet dhe pasojat e krimeve të komunizmit. Nëse shkojmë te neni 3 “Përkufizimet” dhe shikojmë germën “b” thuhet: “Krimet e komunizmit janë veprimet e kryera nga funksionarët e shtetit komunist në periudhën e komunizmit”. A mund të më thoni nëse para 29 nëntorit '44 ka pasur shtet komunist dhe funksionarë? Pra, të jemi në përputhje me parashikimin ligjor, në harmoni të të gjitha parashikimeve të ligjit. Kjo është arsyeja pse është vënë kjo periudhë kohe. Për sa i takon faktit të moshës madhore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke të qartë, sepse ka një logjikë për cilët persona do të ketë. Në qoftë se nuk ke jetuar në atë kohë, nuk mund të kesh nevojë për një certifikatë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Urdhëroni, zonja Mara!

Aurora Mara – Faleminderit, zoti kryetar!

Jam dakord me e propozimin e bërë për projektligjin. Faktikisht jam nismëtare, pra ndër deputetët propozues dhe do t’jua shpjegoj pse. Do të ndalem te neni 1, ku flitet për periudhën e komunizmit. Ne kemi propozuar: “Periudhë e komunizmit është periudha e

historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori '44-ës deri më 8 dhjetor '90". Pse? Në vitin 1941 formohet Partia Komuniste e Shqipërisë. Kjo parti është formuar në '41-shin në një periudhë kur në Luftën e Dytë Botërore në territorin shqiptar bënin pjesë edhe forca të tjera politike. Pra, siç ishte Partia komuniste, kishte dhe forca të tjera që operonin në territorin e Shqipërisë. Në qoftë se ne do të ndalemi te problematikat midis forcave të ndryshme politike në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, sipas meje, nuk është normale, sepse janë problematika ideologjike, probleme të ndryshme midis forcave politike të asaj periudhe, të cilat i kanë zgjidhur në atë kohë dhe ne nuk mund t'i zgjidhim dot sot.

Së dyti, në momentin që flitet për pasojat e komunizmit, flitet për pasojat e një regjimi totalitar, i cili u vendos nga viti '44 e tutje. Ky regjim nuk ishte para vitit '44, sepse ishte një parti si të tjerat. Në momentin e kthimit në një regjim totalitar, atëherë do të flasim për pasojat e këtij regjimi. Pasojat e këtij regjimi nisën në vitin '44, kur u shpall edhe çlirimi i Shqipërisë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi - Në fakt, nuk e di a ka deputetët të tjerë për të folur për këtë çështje. Sinqerisht, këtë jua kam kërkuar edhe më parë, sepse përbën një gjë shumë të rëndësishëm në ideologjinë shqiptare. Dua që të mos i prekim shumë familjet që janë vrrarë, që janë pushkatuar gjatë kohës së sistemit komunist, por edhe kur është krijuar Partia kriminale Komuniste.

Në arkivin e shtetit i keni të gjitha krimet, që kanë bërë kriminelët komunistë dhe kriminelët partizanë. Ju nuk e doni këtë periudhë. E di pse nuk e doni?! Sepse e vërteta tashmë ka filluar të flasë. E dini çfarë më ndan me ju?! Sinqerisht, bota njerëzore, të cilën ju përfaqësoni sot. Cila është Partia Komuniste? A vini ju nga Partia Komuniste, apo vazhdoni të jeni shkëputur prej saj? Çfarë të keqeje ka ta studiojmë këtë periudhë? A ka mundësi të më thotë dikush se çfarë të keqeje ka? Unë jam ballist. Po ju them: i kam marrë të gjitha poshtëritë; tradhtarët na kanë vrrarë, na kanë pushkatuar, na kanë internuar, na kanë burgosur, pra na i kanë bërë të gjitha. I kemi marrë të gjitha poshtëritë që kemi qenë bashkëpunëtorë. Për mua, nuk asnjë gjë të keqe të dalë e vërteta. Çfarë keni ju të mos studiohet kjo? Unë nuk e kuptoj këtë?! Çfarë të keqeje keni?! Pra, kuptoni edhe një gjë që shqiptarët do ta marrin vesh në mos sot, nesër. Sot jeni ju në maxhorancë, por, siç po bëni, do të degradoni tërësisht, sepse nuk po ua jepni të drejtën shqiptarëve për ta mësuar atë realisht se si është. Nga fakti që

ky institut është krijuar dhe falë zotësisë së kryetarit, që është sot, janë botuar disa vrasje krime që kanë kryer kriminelët komunistë dhe partizanë, por juve ju djeg shumë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, por jo me lekët e shtetit, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Më lini të flas, se kur folët ju, unë nuk fola. Urdhëroni! Këtë e keni administruar ju. Shikojeni! Thotë: “Vdekje barbarëve!” Ju e dini cilët janë barbarët? Nuk e dini?! Janë kriminelët komunistë dhe kriminelët partizanë. Nuk e dini ju. “ Shqiptarë,” thotë, “cili komunist ka të drejtë të thirret gjithmonë shqiptar para gropës së shqiptës, ku 170 të këtij vendi shtrihen të therur nga katilët e dushanit?” Urdhëroni!

Ulsi Manja – Çfarë janë këto?

Adriatik Alimadhi - Janë vrasje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju nuk i dini, sepse nuk i keni lexuar

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, kthehuni te projektligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Unë e di që juve ju djeg kjo punë.

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alimadhi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Po, po. Po flas për projektligjin dhe pikërisht për nenin 1.

Ulsi Manja - Për projektligjin duhet të flisni. Fol për nenin 1.

Adriatik Alimadhi – “Periudha e komunizmit është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri në 8 dhjetor...”

Ulsi Manja – Po.

Adriatik Alimadhi – A e kuptoni çfarë keni bërë? Ju vratë ajkën e patriotizmit shqiptar. Ju nuk e keni kuptuar këtë. Ju, sa flasim ne ...

Ulsi Manja – Nuk ka lidhje me ligjin kjo, zoti Alimadhi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Dakord.

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, flisni për ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, lëre ta mbarojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I keni mikrofonat e fikur. Jeni në kafe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alimadhi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Këto janë të gjitha krime, zoti Manja.

Në qoftë se ju do të shkëputeni ... Në nenin 1 thuhet: “periudha e komunizmit është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990”. Pra, nëse ju jeni deputetë, si ka mundësi ...Të ndërgjegjësoheni, zotërinj! Thoni, ta shkëpusim këtë pjesë të historisë.

Ulsi Manja – Ju keni mendimin tuaj, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Shqipëria është një. Si mund të shkëputet Shqipëria? Nga momenti që ju i keni vlarë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Zoti Fino, zoti Tufa, zoti Hyseni, kolegë, a ka mundësi të fokusohemi te ligji, sepse do të kalojmë në procesin e votimit?

Adriatik Alimadhi – Në nenin 1, zoti kryetar, do të kërkoja që të përfshihet e gjithë periudha. Nuk ka asgjë të keqe.

Ulsi Manja – Për procedurë. Kur të vijmë te neni 1, sepse jemi akoma në fazën e diskutimeve (zonja Bushka, zoti Lita) të historisë... Në fakt, këtu ngatërrohet ligji me historinë. Është tjetër gjë studimi, tjetër gjë historia dhe tjetër gjë ligji.

Adriatik Alimadhi – Ju lutem, kryetar, ka thelb kjo! Përderisa ju në ligj ndërhyini dhe kërkon ta rregulloni me kohë të pjesshme që Shqipëria në tërësi është një dhe ka një histori ...

Nuk ka gjë për ne, le të vendoset. Në vitet 41 42 43 kemi qenë bashkëpunëtorë, por ama lërja Institutit, historisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju mos ndërhyjni në ligj duke thënë që fituam ne duke ju vrarë, fituan ne duke ju therur, ju trazuam zorrët nëpër bark. Asgjësuar 4-6 mijë shqiptarë, ajkën e patriotizmit shqiptar dhe tani dilni me tufa me lule. Nuk shkon kjo gjë. Në qoftë se ju do ta vendosni, e keni krejtësisht gabim. Nuk ka vend në botë që të ketë dy kohë të shkëputura nga historia e Shqipërisë. Të shkëputen nga periudha e historisë nga viti 41, që është krijuar Partia kriminale Komuniste deri kur morët pushtetin me vrasje. Kjo nuk ka kuptim! Çfarë të keqe ka? Unë jam tradhtari, vrasësi, bashkëpunëtori dhe unë dua të dalë e vërteta. Ju çfarë doni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë je ti?

Ulsi Manja – Po diskutojmë ligjin.

Adriatik Alimadhi - Jam vrarë unë o zotëri, nuk je vrarë ti. Duhet të kemi kujdes dhe shoqërisë shqiptare t'i ofrojmë diçka serioze.

Neni 2.

Ulsi Manja – Ndizeni mikrofonin, sepse e fika pa dashje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – A doni të mos flas?

Ulsi Manja – Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kolegë, kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri? Kundër? 4 vota kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Tani le ta diskutojmë ligjin nen për nen dhe të rregullojmë ato probleme që ka ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke drejtor Instituti këtu. Atë e përfaqëson Agron Tufa.

Neni 1.

Ka propozime konkrete për nenin 1?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alimadhi, thotë që periudha të rrijë siç është në ligj.

Adriatik Alimadhi – Madje, kryetar, unë do t'i lutesha me dorë në zemër secilit deputet, në përgjegjësi dhe ndërgjegje personale. Në qoftë se ju vendosni periudhë të shkëputur, do të bëni gabimin më fatal dhe historia do t'ju ndëshkojë. Mbajeni mend çfarë po ju them. Po shkëpusni historinë e Shqipërisë, zotërinj. Shqipëria është një e tërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zonja Mara!

Ka një propozim nga zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Ju lutem, kryetar, sepse e lashë në mes!

Është e dobishme për brezat që do të vijnë. Jua thashë me dorë në zemër, por ju nuk doni ta kuptoni. Kam shumë respekt për secilin nga ju. Kam tre muaj e pak deputet, bashkëbisedojmë, japim mendime, japim eksperiencë të ndryshme. Mos u bëni pjesë e disa individëve, të cilët bartin akoma urrejtje ndaj një klase të caktuar. Të gjitha i kemi marrë ne, por ju lutem mos e shkëpusni historinë e Shqipërisë!

Faleminderit!

Ulsi Manja - Zonja Mara, ju lutem thoni diçka për nenin 1.

Aurora Mara – Kam vetëm një sqarim të vogël.

Nëse do të quajmë “periudhë komuniste” periudhën e Luftës së Dytë Botërore, duhet të shuajmë të gjitha forcat e tjera politike, sepse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Do të biem në kontradiktë me çdo gjë tjetër. Në qoftë se periudha e Luftës së Dytë Botërore do të futet në kategorinë e periudhës komuniste, i bie që në atë periudhë ekzistonte ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, më fal! Unë po flas si juriste.

Nëse ato vite të Luftës së Dytë Botërore do të quhen “periudhë komuniste”, atëherë të gjitha forcat e tjera ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zotëri!

Ulsi Manja – Të lutem, ta mbaroj kolegja mendimin!

Aurora Mara – Të lutem, më kundërshto më pas!

Në qoftë se periudha gjatë Luftës së Dytë Botërore do të futet në kategorinë e një periudhe komuniste, atëherë i bie që ekzistonte vetëm një parti dhe do të shuajmë të gjithë historinë e partive dhe forcave të tjera politike. Përndryshe, do të quajmë “periudhë komuniste” periudhën pas vendosjes së regjimit totalitar komunist.

Faleminderit!

Ulsi Manja –Faleminderit!

Zoti Hyseni, nga ju kapi sot ky pasion i madh për historinë? Jemi në miratimin e një ligji.

Adriatik Alimadhi – Jo, jo, është për të drejtën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Në lidhje me nenin 1. Zoti Roshi, zonja Bushka, kolegë deputetë, ju lutem mbani qetësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka replikë midis kolegësh, zoti Alimadhi. Keni bërë një propozim për nenin 1, ndaj më lejo të zbatoj Rregulloren.

Zoti Alimadhi propozon që neni 1, që ndryshon nenin 3, germa “a”, të ngelet siç është në tekstin e ligjit në fuqi. Propozuesit propozojnë ndryshimin. Unë jam i detyruar të hedh në votim propozimin e zotit Alimadhi dhe pastaj nenin 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për propozimin tonë do të pyesim zotin Tufa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person – Unë doja të thosha dy argumente.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Kush është dakord me propozimin e zotit Alimadhi që neni 1, që ndryshon nenin 3, germa “a”, të rrijë siç është në tekstin e ligjit? 3 vota pro. Kundër? Nuk miratohet propozimi i zotit Alimadhi.

Hedhim në votim nenin 1 sipas variantit të nismëtarëve. Kush është pro nenit 1? Kundër? 3 vota kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Braho, a ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, nuk jemi për gjëra personale këtu.

Neni 1 kaloi, kurse për nenin 2 të kemi një diskutim konstruktiv.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për nenin 2 e ka kërkuar fjalën zoti Lita. Pastaj zoti Tufa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Bushka, e ka kërkuar fjalën zoti Lita për nenin 2, sepse ka një propozim.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket nenit 2, duke qenë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person - Nuk është Kuvendi yt. Ti nuk e ke të babait Kuvendin.

Ulsi Manja – Jo, nuk e kam. Por edhe të zbatosh rregullat që i kemi votuar bashkarisht...

Person – Do vij që çke me të.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një propozim konkret për nenin 2.

Siç e tha edhe zoti Murrizi, ky është një nen shumë delikat dhe shumë aktual në politikën shqiptare.

Duke qenë se shumica e të zgjedhurve dhe atyre që bëjnë politikë në Shqipëri, në administratën shtetërore, nuk e kanë këtë certifikatë, unë besoj se është shumë e parakohshme dhe e tepërt t'i kërkohet këtij institucioni, aq më tepër që është institucion studimor.

Në këtë kontekst, në një periudhë të mëvonshme kur të vijë për të gjithë administratën apo politikën, ndoshta mund të futet dhe sigurisht që mund të futet, por për momentin unë propozoj dhe për këtë kërkohet mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj, sepse e di që me forcën e kartonit mund ta miratoni, që ky nen të tërhiqet për momentin.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Lita!

Zoti Tufa, kam një pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Braho, se kam një pyetje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot, në zbatim të këtij ligji, në praktikën e punës së Institutit, si operoni ju me materialet që kërkoni dhe ju vihen në dispozicion?

Agron Tufa – E para, besoj se është një qasje e jashtëligjshme, domethënë për të vendosur këtë kusht total deri te shoferi që të pajiset me certifikatë sigurie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po jua shpjegoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, ta dëgjojmë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Tufa, unë po ju pyes...

Agron Tufa – Me çfarë u tha këtu, unë kam pasur një durim olimpik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – A ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë dua të di një praktikë pune si operoni sot, sepse ligji është në fuqi që nga viti 2010.

Agron Tufa – Ne vetëm administrojmë, nuk prodhojmë dhe nuk kërkojmë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”.

E para, ne nuk mund ta marrim atë që nuk është. Po deshët, vendoseni për të gjithë administratën këtë kriter dhe ne jemi dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – E tha, pra, nuk marrim informacion!

Agron Tufa – Sepse, zotërinj, këtë detyrim taksativ nuk e ka as SHISH-i...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Tufa – ...as Autoriteti i Klasifikimit të Dosjeve, nuk e ka as DSIK-ja, nuk e ka as Shtabi i Forcave të Armatosura, ndërkohë këta e kërkojnë tek Instituti i Studimeve të Krimeve kundër Komunizmit!

Ulsi Manja – Dakord, shumë faleminderit për përgjigjen!

Agron Tufa – Për çështje, si të thuash, të mjegulluara, supozimesh e diversionesh, këto janë qesharake. Edhe letërsia më e keqe groteske nuk i pranon!

Unë jam dakord që të bëjmë në mënyrë kompakte kontrollin për certifikatë sigurie, që e bën DSIK-ja, sepse, jashtë çdo dyshimi, për vete ndihem kristal, i tejdashëm, vetëtitës, por problemi është: cilat duar na e shërbejnë atë?!

Zoti Murrizi e tha...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, se e tha zoti Murrizi atë, zoti Tufa!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zoti Tufa!

Zoti Fino, fjala është për ju.

Bashkim Fino – Pas kësaj përgjigjeje që dha drejtori, unë mendoj që është e tepërt kjo kur ky bën studime, për të cilat nuk kërkon materiale të klasifikuara. Ndaj unë do të bëja një propozim në funksion të nënkryetarit: të hiqet fjalia “e certifikatës së sigurisë së personelit dhe Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, ndërsa pjesa tjetër e ligjit, e nenit, mund të ngelet dhe kështu ne jemi brenda...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ngelemi brenda atyre kontureve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja juaj e zgjidhi përfundimisht dhe nuk do ta kishim bërë gjithë këtë debat tani historik. Mendoj se, duke hequr fjalët “pajisjen e certifikatës”, është një gjë pozitive.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Nëse do të hiqet pjesa e pajisjes me certifikatë, propozuesit duhet të bien dakord të tërhiqet komplet neni 2, ai është i vetmi ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai ndryshim bëhet aty...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam lexuar dhjetë herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Fjalën e ka kërkuar zoti Braho, pastaj do të kalojmë...

Spartak Braho – Unë jam dakord me propozimin që të hiqet.

Duhet të kemi parasysh se te ligji për DSIK-në është parashikuar që pajisja me certifikatë sigurie bëhet vetëm për personat, që kanë të bëjnë me dokumentacion të klasifikuar “sekret shtetëror”. Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, pra, mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord pra!

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Braho!

Spartak Braho – Mendoj të themi kështu: “Kur punonjësit e Institutit studiojnë dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”, të pajisen me certifikatë sigurie””.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

(Debat në sallë)

Zoti Lita, a ka mundësi një minutë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Kur pajis, kur studion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – A ka mundësi, një minutë?

Adnor Shameti – Hidheni në votim atë propozimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Drejtori i Institutit thotë: “Unë nuk punoj me material të klasifikuar përveçse me material të deklasifikuar, që e njeh edhe opinioni publik, sepse jam studiues”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse do t’i duhet të punojë me informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, është në detyrimin e institucionit, që administron dokumentin, t’ia kërkojë certifikatën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Atëherë, kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi, zonja Bushka?

Zoti Braho!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në emër të propozuesve, fjalën e ka zoti Shameti për nenin 2.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Nën dritën e analizës që drejtori na sqaroi lidhur me procedurën që është bërë këtu, sikurse edhe me propozimin shumë të vlefshëm të zotit Fino, në emër të propozuesve kërkoj të tërhiqet neni 2 dhe të lihet ashtu siç është.

Faleminderit!

Ulsi Manja – E hedhim në votim.

Kush është dakord që neni 2 të tërhiqet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3 i ligjit “Hyrtja në fuqi”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, duroni!

Para votimit në tërësi, duke qenë se neni 2 hiqet nga teksti i projektligjit, këshilltarët dhe relatori, përpara se të bëjnë raportin dhe ta çojnë në seancë, të bëjnë numërtimin e ri të neneve.

Atëherë, kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

Shumë faleminderit për durimin dhe debatin!

Këtu e mbyllim rendin e ditës për sot, por, duke qenë se me këtë mbledhje të komisionit mbyllet edhe ky sesion parlamentar, ju uroj pushime të mbara dhe shihemi në seancën plenare të datës 18 korrik!

Shumë faleminderit!

Ditë të mbarë dhe pushime të mbara të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA

